

BIBLIOTEKA
SHTETIT



81H-32

H29

DYLBER
HASANI

Ballkoni
i katit
të katërt

NOVELË



814-52

H 29

DYLIBER HASANI

S

BALLKONI I KATIT
TË KATËRT

59232



1079

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PASOJA E NJË NDËRHYRJEJE

Ajo ndërtesë katërkatëshe ishte në anë të rrugës dhe pikërisht në anën e rrugës, pranë ndërtesës qenë vendosur shtyllat e linjës elektrike. Telat e ngarkuara me korent qenë pengesë për të hequr armaturën e mbulesës së ballkonit të katit të katërt sepse, sado i kujdesshëm të bëhej dizarmimi, që e pamundur që të mos binte ndonjë copë dërrasë sipër telave. Dhe ajo punë duhej bërë pa tjetër. Me përjashtim të atij ballkoni, ndërtesa që gati për dorëzim. I vështirë pat qenë edhe dizarmimi i ballkoneve të tjera të asaj ndërtese, por pozicioni që kishte ballkoni i katit të katërt ndaj telave të linjës elektrike nuk i lejonte punëtorët e brigadës, që ngritën atë ndërtesë, ta merrnin përsipër atë punë, pa u hequr më parë telat nga NISH Elektriku.

Elektriciisti për të prerë korentin dhe për t'i zgjidhur telat nga njëra shtyllë, pas kërkesës së dhjetë që ju bë NISH Elektrikut nga NSHN-ja, erdhi aty nga ora dy pasdite. E përmenda jo më kot këtë orë sepse, sikur elektriciisti të kishte ardhur gjysmë ore më parë, kjo ngjarje që po tregoj nuk do të qe zhvilluar. Por ngjarjet janë rezultat i veprimt të njerëzve që marrin pjesë në zhvillimin e

tyre dhe, derisa nuk i ndalon dot këto veprime, nuk e ndalon dot as zhvillimin e ngjarjeve. Pra, ishte ora dy pasdite, kur elektrikisti po bëhej gati të hipte në shtyllë. Pikërisht në atë kohë, Nezir Hyseni po kthehej nga zyra për në shtëpi. Atij i tërhoqi vëmendjen elektrikisti.

— Ka defekt korenti? — e pyeti Neziri elektrikistin.

— Jo, nuk ka defekt, por jam urdhëruar që t'i largoj telat, derisa të mbarojnë dizarmimin e ballkonit punëtorët e kësaj ndërtese.

Përgjigja e elektrikistit qe shumë e qetë. Nezirit ju duk sikur i tha: «Ja, po ja heq pak lëkurën këtij preshi, sepse qenka bërë me baltë». Kështu ju duk atij, megjithëse elektrikistit as i kishte shkuar nëpër mend fjala «presh». Por mendimet në mendjet e njerëzve marrin drejtime të ndryshme. Prandaj ndodhi që, ndërsa elektrikisti bënte punën e tij të zakonshme, për të cilën e kishin urdhëruar, Nezir Hyseni e quante atë punë krejtësisht të jashtëzakonshme dhe anormale. Një urdhër i tillë ishte dhënë gabim dhe, megjithëse ishte dhënë, në asnjë mënyrë nuk duhej zbatuar.

— Po për sa kohë do të na pritët korenti? — pyeti Neziri elektrikistin.

— Unë kam urdhër vetëm për t'i zgjidhur telat. Kur të më japin urdhër përsëri, unë vij dhe i lidh.

Edhe këto fjalë u thanë po me atë mënyrë të qetë. Dhe kjo përgjigje kaq e thjeshtë, fare pa përgjegjësi, premtonte për një mungesë korenti prej më tepër se dy ditësh, ndërsa dizarmimi nuk zgjaste as dy orë punë. «Një gjë e zakonshme kjo për ata të NISH Elektrikut», mendoi me vete Neziri.

Mendja e tij e shqetësuar vrapoi për te ndeshja e boksit që do të shikonin atë mbrëmje në televizor. Kishte një kohë të gjatë që qe përgatitur shpirtërisht për atë shfaqje. «Dhe ja ku na dalka që do të pritet korenti, për arsye se do t'u dizarmo-ka ballkoni! Punë e madhe! Punëtorët e ndërtimit të kësaj banese le ta zgjidhnin vetë këtë punë, me forcat e tyre dhe pa u rënë më qafë të tjerëve!» Neziri i tha elektrikistit që ta ndalonte punën.

— Unë urdhërin e marr vetëm nga shefi im — u përgjegj ai.

Nezir Hyseni nuk e zgjati. Shkoi në shtëpi dhe, pa lënë ende çantën mbi tryezë, mori telefonin dhe kërkoi NISH Elektrikun. Nëpunësi që dëgjoi zërin e tij, kërkoi më parë emrin e të interesuarit. Emri që dëgjoi ishte mjaft i njohur për nëpunësin. Bile, personit që mbante atë emër, po ai nëpunës i kishte një detyrim të vjetër. Dhe si rrjedhim i atij detyrimi, elektrikistit të ngarkuar për zgjidhjen përkohësisht të telave i erdhi një pusullë ku shënoheshin këto dy fjalë: «Ndërpreje punën!» Dhe poshtë tyre firma e shefit.

O O O

Kjo ndodhi në një kohë shumë të shkurtër, vetëm disa minuta pasi inxhinier Avdiu, i ngarkuari i posaçëm nga drejtoria e NSHN-së për dorëzimin e objekteve kishte ikur nga ndërtesa. Ai e pa elektrikistin kur mbërriti. Ky fakt ishte shumë bindës se armatura e mbulesës së ballkonit të katit të katërt do të dizarmohej pa tjetër atë pasdite. Kjo qe porosia e vetme dhe kryesorja që i dha inxhinieri

brigadierit. Dhe brigadieri u zotua se kjo porosi do të kryhej.

Nezir Hysenin, Avdiu e pa kur vinte nga zyra me çantë të madhe nën sjetull. Atij as që i bëri përshtypje dhe as që kishte përse t'i bënte. E kujt nga ne i shkon ndër mend se mund të kemi ndonjë pasojë, qoftë edhe nga një njeri i vetëm, me të cilin mund të takohemi në rrugë? Po po ta dinte Avdiu se ai burri me çantë të madhe nën sjetull do të bëhej shkak për mosheqjen e linjës elektrike nga ana e rrugës pranë ndërtesës, atëhere ndryshonte puna. Por, derisa s'e dinte, kishte të drejtë të shkonte i shkujdesur, i bindur plotësisht se dizarmimi do të mbaronte atë ditë dhe, si rrjedhim, ndërtesa shumë shpejt do të bëhej gati për dorëzim. Me këtë siguri e shkujdesje ai raportoi në drejtorinë e ndërmarrjes dhe iku në shtëpi.

Dreka ju duk shumë e shijshme. Por këtë drekë të këndshme e preu në mes e trokitura e portës. Gjë e rrallë të vinte njeri në shtëpinë e tij në atë kohë.

E shoqja u ngrit e hapi portën. Një zë pyeti.

— Aty është inxhinieri?

Avdiu e njohu atë zë. Ishte Fatmiri, brigadieri, të cilit i kishte dhënë porosinë.

— Hajde, urdhëro Fatmir — thirri. — Urdhëro, se të dashka vjehrra shumë.

Me siguri brigadieri vinte të raportonte për kryerjen e porosisë. Prandaj e kishte hak të gostitej me një gotë verë.

— Falemi nderit inxhinier, por nuk kam kohë. Po pate mundësi, dil një minutë — foli Fatmiri që nga porta.

Avdiu doli me nxitim. Kur mori vesh ato që

i tha brigadieri, i harroi fare gjellën e shijshme dhe shishen e verës që kishte për drekë.

— Detyra që të kam ngarkuar duhet të kryhet pa tjetër, nata, ditë të bëhet — i tha Fatmiri.

— Por si, në ç'mënyrë, shoku inxhinier?

— Nuk e di! Vrajani mendjen dhe gjejeni vetë mënyrën! Unë kam raportuar në drejtori se ajo punë ka mbaruar. Mua po më zien koka nga punët e mia — tha dhe iku duke e lënë brigadierin te dera.

Brigadier Fatmiri mbeti ashtu më këmbë, pa ditur ç'të bënte, atje te porta e shtëpisë së inxhinier Avdiut. «Si ka mundësi që të vish për t'u konsultuar, për të qarë hallin, për të kërkuar ndihmë në lidhje me punën e përbashkët me një njeri që ti e çmon, e respekton për aftësitë e tij, ke besim se ky njeri do të të ndihmojë me siguri, kurse ky të lë mu si shul te dera me fjalët «Vrajani mendjen?»»

Porta kishte mbetur gjysmë e hapur dhe Fatmiri pa gruan e inxhinierit, e cila gjithashtu vështronte disi e hutuar. Ajo i dëgjoi fjalët që u shkëmbyen midis të shoqit dhe brigadierit «Pastaj, ndërsa Avdiu u largua për në kuzhinë gjithë zemërim, e shoqja qëndroi në korridor, në anë të derës gjysmë të hapur.

Fatmiri s'kishte ç'të bënte më aty dhe u largua.

Atëhere gruaja e inxhinierit e mbylli portën plotësisht. I shoqi po matte me hapa gjatësinë e kuzhinës. U mat që t'i fliste diçka, por ndërroi mendim, ngaqë ju duk sikur ai murmuriste me vete, gjë që e bënte saherë mërzitëj shumë. Dhe vërtet Avdiu murmuriste. Gjithë inatin e kishte sepse u zhgënjye. Kur dëgjoi zërin e Fatmirit, ai kujtoi se porosia që i kishte dhënë kishte përfunduar. «Prit

rrush, e të dalin kumbulla të tharta». Si dreqin vajti e raportoi në drejtori? Po e pa vetë atë dreq elektriciçisti që erdhi, e pa vetë me sytë e tij. Disa minuta më parë mendonte që, në mbledhjen më të afërme që do të bëhej, emri i tij do të përmendej i shoqëruar me fjalët: «Ka qenë gjithnjë në krye të detyrës, dorëzimin e objekteve nuk e ka veçuar asnjëherë nga mendja. Puna e tij sistematike dhe shumë e përpiktë ka bërë që asnjë ndërtesë të mos e kalojë afatin e dorëzimit».

— Ulu të hash — i tha e shoqja. — T'u ftoh gjella fare.

Toni i butë, ledhatues i zërit të saj e shkriçëroi disi.

U ul në tryezë.

O O O

Punëtorët e brigadës që drejtonte Fatmiri, ndërtonin një godinë tjetër afër asaj që ishte bërë gati për dorëzim. Ballkoni me armaturën e mbulesës së pahequr ndodhej karshi ndërtesës së re që po hidhte shtat në katin e dytë të saj. Ballkoni sikur u ankohej punëtorëve, sikur u thoshte: «Ju do të ndërtoni ballkone të tjera, kurse mua më latë kështu, të mbërthyer me armatura. Hiqmini këto shtylla e këto dërrasa, hiqmini që pastaj këtu të vijne banorët e të më zbukurojnë me lule. Ata do të nxjerrin karriçet e do të çlodhen kur të kthehen nga puna, ashtu si çlodheni edhe ju nëpër ballkonet tuaja». Kështu u dukej punëtorëve sikur u fliste ballkoni. Ata e kuptonin vetë këtë, por ja që poshtë atij ballkoni kalonte linja elektrike...

Kështu punëtorët vazhdonin punën e tyre të zakonshme për ngritjen e banesës tjetër. Ata e panë elektriciistin që erdhi për të hequr telat dhe mendimet e tyre, bisedat u harmonizuan me tringëllimat e mistrive e të çekiçëve. Por ata panë edhe Nezir Hysenin, atë burrin me kostum kafe dhe me çantë të madhe nën sqetull, që foli me elektriciistin. Më në fund panë elektriciistin që ndërpreu punën dhe mendimet e tyre u ngatërruan, nuk shkonin sipas ritmit të mistrive e çekiçëve.

Fatmiri erdhi pikërisht në kohën kur punëtorët po ndërronin teshat. Një ndjenjë zemërimi e përzier me pakënaqësi vërehej në fytyrën e tij. Punëtorët ndaluan ashtu siç ishin: kush me pantallonat në duar, kush duke lidhur këpucët e ndonjë tjetër duke veshur këmishën.

Nga dritarja e dhomës dukej ballkoni i katit të katërt, si këmba e një të sëmuri që është shëruar prej kohësh, por që mjekët nuk vendosin t'ja heqin allçinë. Lart në qiell në drejtim me ballkonin, një re qëndronte e palëvizur.

— Armaturën duhet ta heqim sot pa tjetër — e prishi heshtjen Fatmiri.

Shokët filluan të lëvizin. Nuk merrej vesh nëse visheshin apo zhvisheshin. Gojën nuk e hapi asnjëri.

— Urdhëri i inxhinier Avdiut është i prerë — dha Fatmiri. — Duhet mbaruar kjo punë si një e një që bëjnë dy. Se si, punë për ne. Hajde ta diskutojmë dhe të vendosim.

— Ma lini mua — tha Safeti, një burrë me mustaqe të gjata, gjysmë të zeza e të thinjura. — Ja, shkoj e fus levën unë tani dhe i bëj lëmsh me dërrasa e binarë e me gjithë tela.

Dikush qeshi. E qeshura u dëgjua si një krismë e thatë.

Nuk kishte njeri qejf as për fjalët e Safetit, as për të qeshurën që i pasoi.

U rrahën disa variante dhe më në fund u vendos: Do të lidhej armatura me litar. Litarët dhe binarët e mbështetur në ballkon do të tërhiqeshin që brenda nga dhoma. Po të kryhej me kujdes kjo punë, mënjanohesh rreziku që dërrasat e binarët të binin sipër telave. Kjo detyrë ju ngarkua ta kryenin Fatmiri, Hamiti e Stefani, tre shokët më të kujdesshëm. U bë një propozim që të qëndronte gjithë brigada, por u hodh poshtë. Shokët e tjerë të brigadës u veshën dhe ikën.

Kur të tre shokët e lidhën armaturën e ballkonit dhe bënë gati binarët për t'i tërhequr, ishte bërë natë. Ishin lodhur dhe qëndruan të ndiznin nga një cigare. Nuk dukej më ai grumbulli i vogël i reve, që rrinte pa lëvizur sipër ballkonit. Tymi i cigareve dilte nga dhoma ku qenë ulur tre punëtorët dhe përzihej me natën. Ata rrinin pa folur.

Ndërtesa e tyre që vazhdimi i numrit të godinave të tjera në atë blok të madh banesash. Në këmbët e pallateve të reja kishin mbetur disa shtëpi të vogla, të vjetra, si kërpudhat në një pyll me drurë gjigantë. Pritej mbarimi i asaj ndërtesë që edhe ato shtëpi të vogla të zhdukeshin si kërpudhat nga breshëri.

Në ndërtesat përreth u ndezën dritat. Fëmijët që luanin përjashta me peta u futën brenda.

— Ngrihemi tani — tha Fatmiri.

Dy të tjerët qenë të gatshëm.

Një llambë e varur në një shtyllë të lartë në anë të rrugës lëshonte dritë deri tek ata.

Stefani, si më i forti, mbërtheu litarin. Fatmiri me Hamitin kapën nga një binar.

— Një, dy, tre, forca! Hoop!

Gjithë armatura u shkëput e ra sipër ballkonit, me përjashtim të dy binarëve që zunë brenda në dhomë.

Ballkoni u drodh si një njeri që goditet në vend të keq, por që tendos gjithë musklat e nuk bie. Sipër telave të korentit nuk ra asnjë copë dërrasë.

— Më duket u dëmtua ballkoni — tha Fatmiri.

Si larguan lëndën e drurit, Hamiti ndezi një copë letër me çakmak dhe vërejti sipërfaqen e ballkonit.

— Paska krisur — tha me dëshpërim duke shikuar anës murit.

Zëri i tij tingëlloi si një psherëtimë.

Dy të tjerët u afruan. Asaj që i trembeshin, ajo u ndodhi me të vërtetë: ballkoni kishte plasur tej e tej në vendin ku puqet betoni me murin e ndërtesës.

Në rrudhat e fytyrave të tyre të djersitura e të pluhurosura u vizatua edhe ky shqetësim.

— E pat tani — tha Hamiti. — Forcojmë ballkonin që plasi nga poshtë për t'ju shmangur ndonjë rreziku tjetër. Pastaj... Nesër...

Këto qenë fjalët e fundit midis tyre atë mbrëmje. Forcimin e ballkonit e bënë në heshtje. Ikën. Edhe fjalët «Natën e mirë» i harruan.

○ ○ ○

Fatmiri hëngri fare pak darkë, sa të mos thoshin gjë njerëzit e shtëpisë.

— Jam dezurn sonte në ndërmarrje — tha duke u ngritur nga tryeza.

Pa u lënë rast që të pyesnin si e qysh, doli përjashta, i hipi biçikletës dhe rrëshqiti nëpër rrugë.

Mendimet i fluturonin para vrapit të biçikletës. Si drejtin qëllon që edhe teknikja e objektit para dy ditësh që shtruar në spital! Të shkonte te inxhinier Lluka, përgjegjësi teknik i sektorit? Mendim i kotë. Ai do të tmerrohej dhe brenda natës do të alarmonte nëpër shtëpitë e tyre gjithë personelin tekniko-administrativ të ndërmarrjes. Atij i duhej një këshillues i pjekur, më i ditur se vetja, i urtë e zemërdhënës. Jo qaraman.

Po të kush të vinte? Dera e inxhinier Avdiut që mbyllur, prapa syve të habitur të së shoqes.

Biçikleta tërhiqte nëpër rrugë. Mendimet fluturonin në ajër, para biçikletës. Kur fap, mendimi u kap në një ganxhë. Kapsja ju duk e fortë. Mendimi u frenua. Vendosi t'i shkonte në shtëpi inxhinier Zijait. Ai kishte bërë muajin e punës prodhuese në brigadën e tyre. Te Zijai mund të shkonte si të kushdo nga shokët e tjerë të brigadës.

Ora ishte nëntë e gjysmë. Derën e hapi vetë inxhinieri.

— Urdhëro, Fatmir, urdhëro — thirri ai entuziazat dhe e kapi për qafe.

— Kam ardhur për hall pune, inxhinier.

— Hajde, more burrë, brenda një herë, se u gozhdove aty te dera.

Fatmiri kishte vajtur disa herë në atë shtëpi.

— Unë mendova se të përzuri xha Salikua nga shtëpia — filloi të bënte shaka i zoti i shtëpisë, kur u futën të dy në kuzhinë. — Kushedi ç'ka ndodhur, mendova. Ky qerrata Fatmir do të jetë me ndo-

një burbuqe dhe, pasi kanë dalë nga kinemaja, i ka thënë të shkojnë nga shtëpia e tij. Kur i ka parë xha Salikua, ua ka mbyllur derën.

— I ke rënë pikës — tha Fatmiri. — S'ma qasi plaku nusen dhe thashë t'i zë derën inxhinier Zijait. Po tani e lashë te shkallët; kishte turp të vinte brenda.

Inxhinieri e njohu mërzitjen në fytyrën e brigadierit, prandaj nisi t'ja largonte shqetësimin nëpërmjet shakasë. Dhe Fatmiri i dha dorën.

— Ou, kush paska ardhur — foli Merita, duke hyrë. — Dhe unë çuditesha kur dëgjoja nga dhoma, se s'po merrja vesh kush e bënte këtë potere. Po ç'bën kështu, ore Fatmir, se ngrite pallatin! — Ajo i pat dëgjuar fjalët që u këmbyen ndërmjet të shoqit dhe mysafirit. Në këto rrethana duhej të ndihmonte edhe ajo me shakanë e saj.

— Të qeshur qofshi — foli Fatmiri pas pak, por...

Zijai dhe Merita i afruan karriget pranë tij.

...— Ballkoni na mori të plasur, kur i ra pesha e armaturës përsipër... — s'e mbajti dot më shqetësimin dhe e derdhi para atyre dy njerëzve që respektonte.

Unë kujtova se mos ndonjë fatkeqësi nga shtëpia — tha Merita.

Sytë e dy burrave mbetën pa lëvizur. Gruaja kafshoi buzën. Më mirë të kishte heshtur.

— Na bëj nga një kafe — i tha Zijai së shpejti.

Merita mori xhezvenë.

— Pa më trego si ndodhi, Fatmir!

Fatmiri ja tha të gjitha me hollësi. Vetëm në fund përmendi ndodhinë në shtëpinë e Avdiut.

— Interesant — foli thuase me vete Zijai.

Ai dhe Avdiu njiheshin prej kohësh. Ishin mo-shatarë. Bashkë kishin mësuar në shkollën shtatë-veçare. Në mësim qenë konkurentë të fortë.

...Ishte një ditë kur Zijai s'i kishte bërë de-tyrat e algjebres. Në mëngjez u ngrit herët dhe i shkoi Avdiut në shtëpi, për t'u konsultuar në kish-te mundësi ai ta zgjidhte problemin, ose të mundo-heshin ta zgjidhnin bashkë. Te dera e priti nëna e shokut të tij të klasës. Ajo ja qepi sytë sikur do t'i bënte një vlerësim të çastit dhe i tha:

— Adi mundohet shumë duke studjuar. Po të harxhojë energji edhe për të mësuar të tjerët, i dëmtohet shëndeti.

Zijai iku i skuqur deri te veshët. I vinte dhe keq edhe inat.

Ky kujtim e shkëputi nga biseda me Fatmirin.

— Në ç'vend të ballkonit qëlloi pesha më e ma-dhe e armaturës?

— Pothuaj në të gjithë gjerësinë.

— E plasura vetëm në një drejtim ishte?

— Vetëm në një drejtim.

— Gjëra që ndodhin, Fatmir, mos u dëshpëro. Ti je i ri dhe s'të ka rastisur mbase herë tjetër kështu. Ne mund të nxjerrim mësim edhe nga e keqja. Nesër, duke e parë në vend, do të mund të arësyetojmë më mirë.

Merita u pruri kafetë përpara.

— Duhet llogaritur pesha e armaturës — lidhi fjalën Zijai, pasi rrufiti dy herë kafënë. — Në qof-të se kjo peshë kalon nga 300 kg për metër katror, ballkoni e ka pësuar kot. Ndryshe, më mirë që ndodhi tani, se sa më vonë.

Fatmiri doli. Tani ai kishte pranë inxhinier Zijain.

O O O

Inxhinier Avdiu u kujtua për ballkonin, kur u ndodh pranë zyrës së drejtorit të ndërmarrjes. Duhej të raportonte, por çfarë të raportonte se. U kthye mbrapsht.

Që larg ja kapi syri armaturën e hequr sipër ballkonit. Pra, detyra e caktuar prej tij qe zbatuar. Po s'kishte si të ndodhte ndryshe. Dinte ai si të vepronte, dinte si ta kërkonte llogarinë për kryerjen e detyrave të caktuara prej tij. Kishte takt në sjelljen më njerëzit. Dy fjalë i pat thënë brigadier Fatmirit kur i erdhi në shtëpi dhe ja rezultati. Ata që e kritikonin për dobësi, nuk e kuptonin. As e shoqja s'e kuptonte. Ju kujtua fraza që kishte thënë një shok: «Avdiu është truri elektronik i ndërmarrjes». U lëmua edhe një herë pas kësaj fraze.

Mendoj për një çast të mos shkonte fare te godina. Ç'donte, përderisa puna kryesore qe mbaruar?! Por jo, bënte mirë të shkonte. U takonte një falënderim nga ana e tij atyre punëtorëve që s'ja bëjnë fjalën dysh. Do të fitonte pikë me këtë.

Kur u afrua, pa disa njerëz sipër ballkonit të katit të katërt. Njëri prej tyre duhej të ishte inxhinier Zijai. E njohu nga koka gjysmë tullace. Po ky ç'donte këtu qysh në mëngjez!? Veshi i kapi edhe një të rrahur dalte me çekiç. «Ç'paska ndodhur, xhanëm, që po gërmojnë ballkonin me daltë?! Brenda një nate?!»

Përsëndeti ftohtë me një gjysmë «mirë mëngjezi».

— C'bëhet këtu? — pyeti me një ton të acaruar.

— Operacion — tha njëri nga punëtorët.

Zijai ja tregoi me pak fjalë si qe puna.

— More Fatmir, po ç'është kjo hata që pas-keni bërë? — shpërtheu njëherësh inxhinier Avdiu.

— Po ky është krim more! Si veproni kështu pa pikë përgjegjësie?! Kush ju tha të bëni kështu?!

— Ju, shoku inxhinier — foli Fatmiri i nevri-kosur.

— Si ju thashë unë, të shembni ballkonin, ë!? Shiko se ky qëndrim të ngarkon me më shumë faj! Mos u mundo t'ua hedhësh të tjerëve...

— Or ti, inxhinier je, apo çfarë je? — bërtiti Safeti duke shkuar dorën pas mustaqeve. — Prit, or tungjatjeta, të merremi vesh njëherë. Na ardhka tjetri me kobure ngrehur!

Zijai ndezi një cigare, ja zgjati edhe Avdiut paqetën. I futi krahun dhe të dy u larguan nga ballkoni.

Fatmiri po hapte një vrimë në beton, për të zbuluar hekurin. Në këtë përfundim arritën me inxhinier Zijain. Në qoftë se hekuri ishte lart, 4-5 centimetra nën sipërfaqen e betonit, ballkoni s'kish-te rrezik. Në të kundërtën duheshin marrë masa për forcimin e tij. Në rastin e dytë faji i mbetej cilësisë së betonimit. Fatmiri gërmonte, hekuri nuk dukej. Coprat e betonit që thërmonte dalta ngjiteshin në fytyrën e djersitur të brigadierit. Vetëm ai qëndroi aty. Punëtorët e tjerë shkuan të punonin te godina e re.

— Doli hekuri — thirri Fatmiri. Zëri i tij solli pranë Zijain dhe Avdiun.

Hekuri ishte shumë poshtë, gati 3-4 centimetra

nga pjesa e poshtme e ballkonit. Me siguri, gjatë betonimit të atij ballkoni, nga pakujdesia hekurat qenë shkelur.

— Mbase hekurat janë ngjeshur me qëllim — tha si me hundë Avdiu.

— Ama ç'ja këput edhe ti! — tha Fatmiri.

Edhe Zijait i erdhi në majë të hundës me kolegun e tij dhe i foli:

— Mjaft me këto, Avdi!

Avdiu iku duke turfulluar:

— E keni gabim! Do të mbani përgjegjësi! Nuk lejoj më të tilla ndërhyrje brutale në kompetencat e mia, të tilla thyerje të disiplinës teknike! Është e qartë, nguteni për t'i mbyllur sytë së keqes!

Zijai llogariti me afërsi peshën e armaturës që ra sipër ballkonit, duke shtuar këtu edhe peshën që merrte kjo duke u lëshuar nga tre metra lartësi. Ishte mbi 300 kg. për metër katror.

— Pa të zbulojmë edhe një hekur në tjetër vend — i tha Fatmiri.

Hekuri tjetër u zbulua shumë shpejt. Nuk qe shkelur.

Në atë kohë erdhi përgjegjësi teknik i sektorit, inxhinier Lluka. Ai qe takuar në rrugë me Avdiun dhe, nga tronditja, ende s'po e merrte veten.

Zijai ju vu skicës për projektin e riforcimit të ballkonit.


— Më ndihmo për llogaritjet — i tha Llukës, duke i dhënë një fletore.

Tjetri rrinte si i ngrirë.

— Si, kështu me kokën tonë...?!

Zijai e mati me sy.

— Gabime bëhen edhe në punën tonë.



Mirëpo Llukës s'i mbushej mendja.

— Janë punë me spec këto, Zija vëllai. Po doli mirë edhe të thonë edhe s'të thonë bravo. Po doli keq, të mori dreqi... Ti s'ke faj, si inxhinier i ndërmarrjes të bie indirekt përgjegjësia, por mua... Ku djallin ndodhi në sektorin tim kjo bela...

— Ty të pret litari — e thumboi Fatmiri.

— Shiko, ti mos më shit mend! — duke menduar se e kishte përfund, Lluka donte t'ja zbraste atij gjithë dufin. — Kur nuk e drejton dot brigadën, thuaj që s'je në gjendje dhe mos ngatërro të tjerët...

— Për fajet e mia gjykohej unë. Vetëm mos hajde të dridhesh këtu si lepuri kur shikon që i vërtitet shqiponja përsipër.

— Mos u merrni me fjalë kot — tha i treti.
— Llukë, të lutem ndihmomë për llogaritjet!

— Po unë për atë erdha, sapo mësova për këtë ndodhi — tha Lluka. Të paktën donte t'ua mbushte mendjen të pranishmëve që nuk qe aq frikacak sa ç'u tregua.

* * *

Kryeinxhinieri i ndërmarrjes, një burrë thata-nik, me thinja në tëmthat i ngjiti shkallët e godinës duke ecur me hapa të shkathtë e të vegjël. Avdiu detyrohej t'i bënte hapat më të shkurtër, për të qëndruar një shkallë më mbrapa në të majtë të tij. Dy-tre inxhinierë të tjerë dhe disa shokë të byrosë teknike vinin pas tyre si një grup njerëzish të shkujdesur.

— Mirë mëngjez, Zija! Ky ballkon është ndër-tuar, kur ju bënit punën prodhuese.

Zijai uli pak kokën si të thoshte:

«Po, atëhere është ndërtuar»

Avdiu doli para të gjithëve si të donte me çdo kusht të binte në sy.

— Ta pret mendja — tha ai — ndryshe s'do të gdhiehej sipër ballkonit me daltë e çekiç në dorë bashkë me Fatmirin.

Përmes vetullave të dendura, sytë e kryeinxhinierit u ndezën papritur, si të donin të dëgjonin mendimin e shprehur nëpërmjet fjalëve të Avdiut.

— Më qetë, pa nerva! Si specialistë ndërtimi, ne kemi mundësi ta rregullojmë këtë punë pa qenë nevoja të grindemi e të alarmohemi.

— Natyrisht, gabimi shlyhet me punë — foli Fatmiri.

Avdiu bëri disa hapa të rrëmbyer nga ballkoni në dhomë, u kthye me vrull nga të pranishmit, eci përsëri e u ndal dy hapa para Fatmirit:

— Punë të bukur! Ja puna juaj — tregoi me dorë të plasurën e ballkonit. — Po të shprehësh me gjuhën popullore, mund t'ju thosha pa ngurim: Pini lëngun!

Fatmiri në dorën e djathtë mbante çekiçin, në të majtën daltën. I përplasi veglat njëra me tjetrën. Ato lëshuan një tingull të egër. Vështrimet e njerëzve mbi ballkon u përqëndruan te duart e Fatmirit. Ai, i zemëruar, u përkul të gërmonte mbi beton.

Zijai shpejtoi dhe nxori para kryeinxhinierit skemën për rindreqjen e ballkonit, të cilën sapo e pat mbaruar me Llukën.

— Zhgarravina qesharake — konstatoi Avdiu — vetëm sa për të thënë që merremi, preokupohemi me punën, sa për t'i dalë së keqes përpara.

Zijai kafshoi buzën e poshtme për të mbajtur ndonjë fjalë të pamatur që mund të thoshte në gjak-nxehtësi e sipër:

— Meqë jemi shumë e studjojmë bashkë, s'pretendojmë që kjo skicë e vogël është aq e përkryer, sa të mos u nënshtrohet vërejtjeve.

— Atëhere bjeri drejt edhe mos na sorollat duke na paraqitur një letër që nuk përmban asgjë sipër saj! Betoni nuk është si brumi! Ajo që thuhet duhet prishur e gjitha e pastaj të ndreqet përsëri si duhet. — Avdiu i drejtohej Zijait, ndërsa me vështrim përpiquej të përfshinte gjithë të pranishmit.

Zijai ndjeu papritur epërsinë e tij përpara Avdiut që, për të vënë në rrugë vetëm mendimet e tija, kapadaillëkun, sedrën e sëmurë, përdorte fraza të paarësytuar, fliste me nerva dhe i papërmbajtur. Këtë epërsi e ndjente jo aq nga aftësia profesionale, se sa nga të kuptuarit drejt të qëndrimit që duhej mbajtur edhe atëhere kur punët nuk shkojnë grurë, ashtu siç dëshirojmë. Kur Avdiu fliste, i zgjeroheshin flegrat e hundës dhe mjekra i dridhej, si ta zinin ethet. Zijai e ndjente aty praninë e Avdiut, praninë e kryeinxhinierit dhe të gjithë shokëve të tjerë dhe donte që arësytimet e tija të puqeshin me arësytimin e përgjithshëm. Kurse Avdiu ngulmonte me çdo kusht ta dëgjonin të gjithë, ta mbështesnin të gjithë dhe (s'do mend) të merrnin parasysh gjykimet e kërkesat e tija.

«Mësuesi i algjebërës u dha në klasë një problem me konkurs. Ai që do ta bënte problemin të plotë brenda dhjetë minutave, do të shpallej «nxënësi më i shkathët i ditës». Zijai e mbaroi për shta-

të minuta. Problemi qe mjaft i vështirë dhe të tjerët ngecën.

— Hajde, bëje problemën në dërrasën e zezë — i tha mësuesi Zijait.

Avdiut i vinte të pëlçiste nga inati që po ja kalonte.

Kryeinxhinieri shikoi orën. Ishte njëmbëdhjetë e gjysmë.

— Tani, brigadier, lajmëro shokët e brigadës se do të bëjmë një mbledhje të shkurtër. Në orën dymbëdhjetë e gjysmë, të gjithë sa jemi këtu, në zyrën e drejtorit!

NGA NJË E PLASUR DALIN TË TJERA

Ç'kishin ata ashtu, që i varën kryet si t'u kishin lidhur nga një kovë me beton në qafë? Po muskujt e tyre të mësuar gjithmonë me lëvizje, pse u mpinë si një damar i prerë? Ç'të ishte ajo ndjenjë që qysh në mëngjez ua kishte kyçur gojën? Dhe kur brigadieri i lajmëroi se kishte mbledhje, sytë u ngjitën pas gjokseve.

Ata ishin të tronditur. Kjo vërehej në mustaqet e Safetit të varura deri poshtë mjekrës; në gishtërinjtë e mëdhenj të Hamitit, të cilët, pa ditur si, kapërdiheshin njëri me tjetrin. Kjo dukej në sytë e Fatmirit. Ai do ta hapte moledhjen. Ata sy thyheshin sapo ndesheshin me fytyrat e vrejtura të shokëve dhe ndalonin vështrimin sipër duarve të tij, vendosur mbi tryezë. Të gjithë punëtorët shikonin duart. Po ç'kishin ata me duart? A nuk

tregonin ata damarë të trashë, ata gishta të zhvilluar, se ato duar asnjëherë s'e kishin kursyer veten? Po! Po! Po! Por këtë radhë...

— Shokë! Këto duar nuk do të na lënë në baltë.

Fatmiri mblodhi gjithë kurajon që i duhej dhe e hapi mbledhjen.

Sytë e të gjithëve u mbërthyen tek ai.

— Me këto duar ne do ta shlyejmë gabimin...

— Jo gabim, por faj, faj i rëndë — kërceu inxhinier Avdiu.

Fatmiri e shikoi me qortim dhe vazhdoi:

— Nuk desha ta bëja më të lehtë duke e quajtur gabim. Ky mund të jetë i katërqindti ballkon që kemi ndërtuar ne. Kemi kryer punime të tjera më të vështira. Por e quajta gabim, shoku inxhinier — sytë e tij u drejtuan si prozhektorë drejt Avdiut — duke pasur parasysh këtu vetëm veprimin e brigadës. Se për ta quajtur faj, duheni përfshirë edhe ju, gjithë personeli teknik i ndërmarrjes. Veçanërisht përgjegjësia bie mbi ju, që preokupoheni për dorëzimin e objektit vetëm kur bëhen instalimet elektrike dhe hidraulike. — Avdiu u thye nën vështirimin e atyre syve. — Meqë njëri hekur i ballkonit që gjeshur poshtë, tregon se kujdesi ynë nuk ka qenë ai që duhet të jetë. Nga kjo që ndodhi duhet të nxjerrim mësim. Por në asnjë mënyrë nuk duhet të kalojmë në ekstremin tjetër; meqë na plasi ky ballkon, të mendohet se ky kolektiv nuk është më në gjendje të kryejë punë të tjera të vështira me cilësi të mirë. Populli thotë: «nuk vërehet kali me një herë të rrëzuar». Edhe për brigadën tonë kjo është e rrëzuara e parë. Dhe pas kësaj ne do të

ngrihemi më të fortë. Këto nuk i them rastësisht. Kam vërejtur se ndonjë shok, si inxhinier Avdiu dhe inxhinier Lluka, janë alarmuar aq shumë, saqë ka mundësi të mos besojnë më në kolektivin e brigadës sonë. Kaq kisha — tha Fatmiri duke përfunduar. — Gabimin do ta shlyejmë me punë!

— Unë jam i paqartë — kërceu Avdiu. — Vetë brigadieri tha që ne kemi përvojë në punë. Nga kjo del se puna e dobët në betonimin e ballkonit nuk është bërë nga padija, por nga mospërfillja e disiplinës teknike. Ai është mendjemadh. Dhe e fundit: përse quhem edhe unë bashkëfajtor?

Fatmiri deshi të ngrihej, por kryeinxhinieri i bëri shenjë me dorë që të mos ngutej.

Fjalën e mori Jovani:

— Inxhinier Avdiu i ra pikës. Neve na vjen e keqja nga mendjemadhësia e vetë brigadierit. Ai e heq veten sikur i di të gjitha dhe nuk përfill as teknikët, as inxhinierët, kur i bëjnë vërejtje. Të vetmet vërejtje të pranueshme për këtë njeri janë ato që i bën inxhinier Zijai. Më e keqja këtu është se veprimet e brigadierit mbështeten fuqimisht nga gjithë brigada. Sido që të veprojë ai, të tjerët «amin». Kështu ndodhi edhe kur u betonua ballkoni për të cilin po diskutojmë. Unë nuk isha dakord që teknikja të mos rrinte atë natë në betonim. Brigadieri me të tjerët i thanë të ikte. Ajo iku dhe ja ç'na doli...

Këto fjalë shkaktuan zhurmë midis punëtorëve.

— Po ajo ishte e sëmurë — u dëgjua mbi të gjithë zëri i Safetit.

— Lëre, ç'ke me të, kështu ja këput Jovani —
tha një tjetër.

— I erdhi lepuri në shteg.

Jovani bëri përpjekje për ta ngritur zërin mbi
të gjithë:

— E shikoni ç'bëjnë? Përherë kështu ndodh
këtu. Po i kritikove, të mbytën. Prandaj, ju lutem,
vini dorë! — Fjalët e fundit Jovani ja drejtoi krye-
inxhinierit.

— Pa fjalë! — thirri Avdiu. — Lëreni të flasë
dhe nxirrni mësim nga diskutimi i tij!

— Por Jovani qe ulur.

— Ngrehu prapë, Jovan, dhe thuaj të gjitha —
e nxiti Lluca.

U çua Safeti dhe po fërkonte mustaqet:

— Me leje! Kush e drejton këtë mbledhje?

— Më qetë, shokë, më qetë — tha kryeinxhi-
nieri.

Safeti vazhdoi: — Këtu, or byrazer, u bënë dy-
mbëdhjetë pleq e njëzet e katër çibukë. Ne e pri-
shëm që folëm pa radhë, por Jovani na shpoi keq
në brinjë. Si ore, gjithë brigada qenkan mendje-
mëdhenj dhe vetëm Jovani i thjeshtë, modest, si
i thonë ndryshe! Por ama, ti, shoku kryeinxhinier,
ti, or xhani i vëllait, nuk duhet t'i lejosh këta var-
tësit e tu që, ku të shikojnë xixë zjarri, të hedhin
benzinë. Po i bie shkurt. Fajin, që është shkelur
hekuri i ballkonit, e kam unë, sepse unë e kam be-
tonuar atë ballkon. Ja si ndodhi, tani më kujtohet
mirë: punëtorit që sillte betonin i shpëtoi karroca
sipër hekurave. I drejtova. Kujtova se i drejtova
të gjithë, por ja që njërin, atë më kryesorin e pas-

kam harruar, ngaqë ishte mbuluar. Fatmiri e quajti gabim. Unë e kritikoj dhe e ftoj që ta tërheqë. Ky është faj dhe fajin e kam unë...

— Me se e dënove veten ti për këtë faj — ndërhyri Avdiu.

— Prit, or ti, mos e prish fjalën tani! — u nxeh Safeti. — Hej, ç'më ngatërrove, mor i uruar. Hë de, se u kujtova. Ai diskutimi i Jovanit është me hile. Ne, si brigadë, i kemi ulur Jovanit një kategori për punë jo të mirë. S'ka dhomë që ta suvatojë Jovani e të mos jetë nevoja për t'ja rregulluar një tjetër prapa. Kurse Avdiu me Llukën nuk e duan Fatmirin se i kritikon vënçe. Mua më hoqi mënjanë një ditë Avdiu e më tha që Fatmiri është i papjekur, i rrëmbyer, prandaj ta zëvendësojmë me Jovanin. Unë e bëra çështje në brigadë. Qysh atëhere puna mori të plasur. Kjo e plasur sikur u mbulua, por ja që u shfaq prapë nga e plasura e ballkonit.

Pas Safetit e mori fjalën Avdiu. Ai i bëri një hyrje teorike diskutimit të tij, duke dashur të analizonte ç'është faji e ç'është gabimi, ç'dallim kanë njëri nga tjetri dhe se mosnjohja e këtyre dallimeve bën që të kryhen faje e gabime të tjera më të rënda nga ato të fillimit. Këto, sipas tij, ishin shkaqet e fajit të madh për të cilin ishin mbledhur. Nga ky shkak kjo brigadë kishte gabuar dhe do të gabonte vazhdimisht derisa të kuptonte drejt përcaktimin e nocionit «faj» dhe nocionit «gabim». Sipas tij, i komplikuar në këto mendime të gabuara ishte edhe inxhinier Zijai, që gjatë kohës kur bëri punën prodhuese në këtë brigadë. Më tej ai tha se brigada duhej shpërndarë pa tjetër, ndryshe puna e saj do të ecte përherë e më keq.

Diskutimet u përlëshën. Nga njëra anë qëndro-

nin Avdiu, Lluka dhe Jovani, nga ana tjetër brigada dhe Zijai. Të tjerët ende s'po e thoshin fjalën e tyre.

Trokiti dera. Hyri drejtori i ndërmarrjes. Kryeinxhinieri atëhere u kujtua për mbledhjen e dytë të asaj dite. Ora po kalonte nga një e gjysmë. Drejtori u ul te një vend i lirë midis Llukës dhe Zijait.

— Të vazhdojnë diskutimet — tha ai.

Po fliste për herë të dytë Avdiu i ngacmuar keqas nga diskutimi i Zijait. Ardhja e drejtorit ja ngatërroi lëmshin e frazave që do të lëshonte para dëgjuesve.

— Shkurt dhe konkretisht — orientoi drejtori. — Nuk na duhet të rrimë tani e të qajmë për atë që ndodhi. Çfarë masa duhet të marrim.

Fjala «masa» e shqiptuar në gojën e drejtorit e rrëqethi inxhinierin e ngarkuar për dorëzimin e objekteve. Një zë i brendshëm i thoshte se përgjegjësia do të binte kryesisht mbi të.

— Unë mendoj që brigadieri të shkarkohet, shoku drejtor.

— Tjetër masë? — e nxiti.

— Gjithë specialistëve të brigadës t'u zbritet nga një kategori, kurse Safetit, që ka pjesë më shumë në këtë faj, dy kategori.

— Tjetër?

— Të merret masë për teknikën.

— Tjetër?

Avdiu ndaloi. Sytë e tij bënë një pushim te fytyra e drejtorit që, ulur në stol, i vëmendshëm dhe i përqëndruar, ndiqte diskutimin e Avdiut.

— Tjetër?

«Ka disa momente në jetë që duhet të bëhemi edhe kërcimtarë, nevojiten pelivanllëqe. Derri e çan baltën drejt, ai që është i zgjuar, e zgjedh vendin edhe kalon pa u ndotur».

Avdiu deshi të bënte disa hapa nëpër dhomë. Kështu e kishte zakon t'i përballonte tallazet e shqetësimeve në rastet kur ndodhej ngushtë, por kësaj radhe e pengonin stolat dhe njerëzit e ulur ndër ta.

— Tjetër masë? — përsëriti drejtori. — Vazhdo! Të shkrihet byroja teknike e ndërmarrjes, dega e planit, të shkarkohet drejtori, kryeinxhinieri! Atëherë, mund të besojmë se rregullohet puna. Ne kemi parasysh punën e të gjithëve ashtu edhe tuajën. — Avdiu që i detyruar t'i nënshtrohej shikimit shpues të drejtorit. — Të gjithë kemi për qëllim që të punojmë mirë. As që e vlen të merremi këtu me masa ndaj njërit apo tjetrit.

— Dakord, por duhet të ndahet përgjegjësia — e rrëmbeu fjalën Avdiu — sepse ndryshe mund të na ndodhin disa raste të tilla. Prandaj mendoj të mblidhet një konsultë e gjithë ndërmarrjes, ku të merret mësim nga puna jo e mirë që është bërë në ndërtimin e kësaj godine.

— E pastaj?

Avdiu u ul. E kuptoi që drejtori, nëpërmjet një pyetjeje të thjeshtë, shprehte mosaprovimin ndaj mendimit të shfaqur nga ai vetë. Zijai mundi t'i lexonte mendimet e kolegut të tij, Avdiut, që i pasqyroheshin në fytyrën e mbuluar nga djersët. Ata ndodheshin përkundrajt dhe herë-herë kryqëzonin vështrimet.

Në ndërmarrjen ku filloi punë Zijai, inxhinierët numroheshin me gishta. Ai rrinte ditë e natë sipër projekteve, i studjonte, i përpunonte në fillim në mendje, pastaj përpiquej të bënte ndreqje, modifikime. Kështu i lindi ideja që çatitë e disa depove, të cilat në projekt parashikoheshin me lëndë të rrumbullakët, të bëheshin me kapriata. Në këtë mënyrë shpejtoheshin punimet dhe kursehej lënda e drurit në mënyrë të konsiderueshme.

Çdo gjë e re sjell ndryshime. E panjohura gjithnomë është e papërcaktuar plotësisht.

Modifikimet e bëra nga inxhinier Zijai ngjallën diskutime në degën e projekteve. Vetë projektuesi, inxhinier Avdiu, erdhi në ndërmarrjen e ndërtimit. Ç'ishin këto pelivanllëqe prej aventurieri, këto sharlatanizma që bëheshin në kurriz të shkençës së ndërtimit?

Propozimet për ndryshimet në projekt u kthyen mbrapsht. Inxhinier Zijai kishte ngulur këmbë të rishikoheshin ndryshimet e propozuara prej tij. Këshilli teknik e përkrahu. Përsëri diskutime me pasion, tringëllima zilesh telefoni, çjerrje e britma nëpër receptorët vesh më vesh, përplasje dyersh me vrull, zbritje me rrëmbim nëpër shkallë.

Më në fund erdhi aprovimi me një shënim: «Shikoni, keni përgjegjësi të rëndë...»

Depot, projektet e të cilave u modifikuan nga inxhinier Zijai, u ndërtuan gjatë verës dhe në vjeshtë u vunë në funksionim. Çdo gjë shkoi për mrekulli. Por ato depo u ndërtuan në një zonë malore, ku atë dimër ra pothuajse trefishi i dëborës që binte zakonisht. Dhe si pasojë njëra nga çatitë u rrëzua.

Zijai po merrej me një modifikim të ri. Përqëndrimin e vëmendjes te puna e prishi zilja e telefonit. Në fillim nuk ja vuri veshin, ngaqë kujtoi se do të qe ndonjë bisedim i zakonshëm. Por zilja e telefonit vazhdonte të tringëllinte si një ulërimë, si një sirenë zjarrfikësish.

— Alo, urdhëroni!

— Paraqituni urgjent në zyrën e...

— Si është puna?

— Nisu shpejt! Sqarimet e nevojshme do t'i marrësh këtu.

Në ministri, në zyrën ku hyri inxhinier Zijai, u gjend përballë inxhinier Avdiut.

— Urdhëroni, uluni — i tha ai dhe i zgjati paqetën e cigareve.

— Si është puna? — pyeti me padurim Zijai.

— Qetësohu, qetësohu — ja priti tjetri. — Ke për ta marrë vesh shpejt. Pa na thua njëherë si je me shëndet, a lodhesh ndopak? Po na bën ndonjë punë të re krijuese?

Pyetjen e parë e të dytë Zijai i la mënjanë; kapi vetëm të tretën. A thua vërtet po ndryshonte rivali i tij? Sidoqoftë këto qenë shenja të një sjelljeje të mirë dhe ai ju përgjigj sinqerisht:

— Po parashikoj ndryshimin e projektit të një fonderie, tek e cila fillojnë punimet së shpejti. Po të keni kohë, mund të më ndihmoni...

Nga vendi ku rrinte Avdiu u dëgjua një e qeshur.

— Si nuk mësove një herë. Të këshilloj si shok që të heqësh dorë...

Durimi i Zijait humbi.

— Puna kërkimore duhet të mos ndërpritet,

shoku Avdi. Mbi këtë temë kemi biseduar edhe herë të tjera. Ju na keni penguar, në vend që të na për-krahni. Sidoqoftë, ne me forcat tona kemi ecur.

— Të bukur të ecur. Ke ecur havadan, siç bëre me çatitë e depove. Shko shikoi si janë bërë rrafsh me tokën!

Pa tjetër që kjo qe gënjeshtër. Të qenë rrëzuar të gjitha depot vërtet? Po pse pikërisht Avdiu t'ja jepte këtë lajm?

— Nuk është e vërtetë! — bërtiti dhe ju afrua tjetrit pranë. Nga nervozizmi duart i mbante sikur do ta mbërthente për gryke.

Zijai u vërsul me rrëmbim nga dera. Kur u ndodh jashtë, dëgjoi zërin e Avdiut nga brenda:

— Do ta shikosh, do ta shikosh me këto kërcënime...

* * *

...Dhe tani ata ndodheshin përballë njëri-tjetrit.

Zijai kishte ardhur i ftuar nga Fatmiri. Si shef i planit të ndërmarrjes, ai mund ta jepte ndihmën pa i hyrë valles drejtpërdrejt, pa qenë nevoja të merrej me përpilimin e skemës për rindrëqjen e ballkonit. Kështu dilte që të konsultoheshin me Avdiun thjesht si inxhinierë dhe, me këtë rast, shmangej konflikti midis tyre.

Ai nuk mund të rrinte jashtë valles. E thërriste jo vetëm pozita dhe ndjenja profesionale, por, para së gjithash, përgjegjësia morale. Një muaj rresht punoi me punëtorët e asaj brigade në ndërtimin e asaj godine. E dinte mirë se cila pjesë e ndërtesës

qe ngritur në kohë të mirë apo në shi, ditën apo natën. Në betonimin e soletës së katit të katërt. për shembull (atëhere u betonua edhe ai ballkon). punoi gjithë natën. Shkarkonte kovat e vinçit.

Pa diskutim, çështja që shtrohej e prekte Zinjain si të gjithë anëtarët e tjerë të brigadës së Fatmirit. Për një muaj rresht i fliste atij: shoku brigadier, njësoj si Safeti, Hamiti apo Stefani... Për çdo punë të mirë, emri i Fatmirit edhe i gjithë kolektivit qenë përmendur e nderuar vazhdimisht. Edhe kur puna e tyre mori të plasur, i pari, emri i Fatmirit do të merrei nëpër gojë...

Diskutimet vazhdonin. Herë me fjalë të shtruarra, herë të rrëmbyera, mendimet ngjisheshin pas veshëve të secilit.

Pas ardhjes së drejtorit dhe sidomos pasi ju pre rruga «për t'i bërë dredha plumbit», nëpërmjet diskutimit të tij, Avdiu vendosi të qëndronte në pozitë e këqyrësit, duke marrë pamjen e njeriut që mundohet për mirë me mish e me shpirt, po që s'e kuptojnë, ja marrin për keq.

«Detyrohem t'ju shpjegoj ato që di, dhe jam i bindur se veproju drejt. Tani mbetet të mbyll sytë. Bëni si të doni».

Por ai s'mundi të qëndronte gjatë në rolin e atij që vetëm mban vesh, shikon e nuk flet. Diskutantët po e shprehnin hapur kundërshtimin e tyre ndaj mendimeve të tij.

— T'i referohemi faktit — foli Avdiu, pa vënë fare në hesap kundërshtimet. — Urdhëroni: ballkoni i plasur qoshe më qoshe. Thoni po të doni se këtë e bëra unë.

Drejtori u ngrit dhe nisi të fliste pa e drejtuar plotësisht trupin.

— Në këtë çështje, si pikënisje, inxhinier Avdiu ka të drejtë. E them si pikënisje, sepse problemi që diskutohet zë fill pikërisht te plasja e ballkonit. Pa të futemi më thellë...

...Rrugët duhen kërkuar thellë: në qëndrimin e secilit ndaj punës, ndaj gabimeve në punë. Konkretisht: ç'e shqetëson Fatmirin dhe çfarë Avdiun në lidhje me të plasurën që pësoi ballkoni? Përveç kësaj, kush është më trim e kush frikaman në këtë shqetësim? Dhe të mos ngurojmë ta themi: Avdiu ka nevojë të marrë nga guximi i Fatmirit, dhe Fatmiri diçka nga maturia e Avdiut. Përgjegjësia nuk bie vetëm mbi këta, por edhe mbi të gjithë ne të tjerët. Prandaj shqetësimi i tyre përzihet, bëhet i njëjtë me shqetësimin e Fatmirit e të Avdiut. Po cilën anë do të marrim? Është e domosdoshme të bindemi jo sa për ta kaluar çështjen. T'u lëmë rrugë të lirë ndeshjes, zhvillimit të kontradiktës. Ai që ka të drejtë fiton. Kush është i guximshëm, dhe nëse gabon, bën autokritikë.

U ndie zhurma e stolave që liroheshin nga pesha e trupave të njerëzve. Të gjithë dilnin nga dhoma me mendimin se kontradikta do të vazhonte edhe pas mbledhjes.

DY ANË TË NJË RRUGE

Si dolën nga mbledhja, gjithë shokët e brigadës, midis tyre dhe Zijai, ecën së bashku. Edhe Jovanit i vinte zor të largohej dhe ecte pa folur pas shokëve.

— Sikur të kisha pare me vete, sonte do të bëhesha kandil — tha Safeti.

— Njerëzit e humbur dehen kur u ngec puna — ja priti Stefani.

— Një apo dy gota birrë mund t'i kthenim. Kështu siç jemi — ndërhyri Fatmiri.

Edhe të tjerët futën duart nëpër xhepa. U mblodhën rreth 80 lekë.

— Vemë — foli Safeti.

— Unë do të iki se kam fëmijët në kopësht.

— Hë, mirë, ikë ti, ikë, se të qajnë kalamajtë, vetëm ti ke pjellë!

Jovani u largua duke lënë mbrapa zhurmën e këpucëve dhe duke marrë mbi shpatulla vështrimin e shokëve.

U futën në një lokal dhe afruan tri tryeza bashkë.

— Kali e përdredh nga e përdredh bishtin, po do ta përplasë se s'bën te vendi ku e pickojnë mizat — tha Safeti.

— Fundja, bishti prandaj është, për të trembur mizat dhe gjuha për të shprehur shqetësimet.

— S'më hiqet nga mendja qëndrimi i Avdiut — tha Fatmiri.

— Inxhinier Lluca i doli krah Avdiut deri sa pa ardhur drejtori. Pastaj u përmbodh në vetë-vete, si breshka kur mbështjell gjymtyrat, sapo ndjen të trokitura mbi samar. Edhe Jovani s'u ndie më. Kurse Avdiu... Ai ngulte këmbë se edhe ballkonet e tjera nuk mund t'u kishin shpëtuar defekteve — foli i zemëruar Safeti.

— A nuk vemë kështu siç jemi dhe i ngarkoj-

më edhe një herë me peshën e duhur, t'u bëjmë provën për herën e dytë? — tha Fatmiri.

-- Por me se t'i ngarkojmë? — tha Qerimi.

-- Me se?! — u përgjegj Fatmiri. — Me tulla. I marrim nga godina e re që po ndërtojmë.

-- Dakord — thanë të gjithë njëherësh dhe u ngritën. Ata dërguan Qerimin, më të riun e brigadës, që të shkonte në shtëpinë e secilit dhe të lajmëronte se do të ktheheshin vonë atë natë ose s'ktheheshin fare.

Natë e bukur vere. Në net të tilla bulevardet mbushen me njerëz, gumëzhijnë nga hapat dhe bisedat gjithë gjallëri. Por ata nuk do të jenë në shëtitje. As në shtëpi. Edhe Fatmiri nuk do t'i shkonte Donikës në takim atë mbrëmje.

Secili me gjashtë-shtatë tulla në duar, ngjitej nëpër shkallët e godinës dhe i vendoste stivë sipër ballkonit. Pasi ngarkuan tri ballkone, qëndruan të çlodheshin. U ulën në një dhomë, ku hynte më lirshëm drita e njërës prej llambave të rrugës.

«Avdiu qëndronte larg këtyre zërave gazmorë», mendoi Zijai. Por dikur edhe ai vetë s'ka qenë kaq afër sa tani. Dhe ju kujtua rrëzimi i çatisë.

«Shkaku i vërtetë i shembjes së çatisë së njërës nga depot që dëborën e tepërt dhe një kapriatë e montuar keq. Thyerja e saj rrëzoi gjithë çatinë. Po ç'rëndësi kishte kjo! Kaq vlente vetëm sa për ngushëllim. Dhe ai për ngushëllim s'kishte nevojë. Ai ndjente dhembje, dhembje në ndërgjegje. Këtë si do ta shëronte?»

U ngarkua që të shkonte në krye të një brigade ndërtuesish prej njëzet vetësh. Depua që e mbushur me drithë dhe një pjesë e saj, e lagur nga dëborën, ishte prishur. Pjesën tjetër e mbuluan me

mushama. Së bashku me fshatarët e asaj zone mallore mbajtën lëndën e prerë gjatë verës midis pyllit. Dëbora binte papushim dhe era frynte si e tërbuar. Zijai punonte vazhdimisht me punëtorët e fshatarët. Gishtat i ngrinin nga të ftohtët dhe, kur kthehej në mbrëmje pranë zjarrit, i digjnin si të nguleshin dhjetëra gozhdë nëpër ta. Shokët e tij, me të cilët përballonte dëborën, tufanin, lodhjen, nuk e ndjenin atë dhembje. Ata bënë shaka nga më të zakonshmet, qeshnin me rrezikun që u kanosej çdo sekondë. Terreni nga transportuan lëndën e drurit që shumë i thyer dhe mjaftonte një rrëshqitje e vogël e këmbës, për t'u rrokullisur në humnerë. Entuziazmi i shokëve e ngrohte Zijain. Ata të gjithë ngroheshin nëpërmjet atij entuziazmi. Çatinë e depos e rindërtuan brenda tri ditësh. Puna, lodhja, sakrificat ja patën lehtësuar disi dhembjen e ndërgjegjes inxhinier Zijait. Por thellë në brendësi të tij ai e ndjente se kaq nuk mjaftonte për të shlyer gabimin. Çatia e re ishte bërë me lëndë të rrumbullakët. Si rrjedhim, s'kishte mundësi të bëheshin kapriatat në ato rrethana. Kjo i jepte dorë inxhinier Avdiut që të deklamonte pa kurrfarë drojtjeje aftësitë e tij gjeniale për të projektuar ndërtesa që jetojnë ndër shekuj. Ai vazhdimisht fërkonte pëllëmbët e duarve njëra me tjetrën sa, kush e shikonte për herë të parë, mendonte se kishte për qëllim të riprodhonte zjarrin primitiv. Thonë se qysh atëhere i është bërë ves fërkimi i duarve, gjë që e bën me rrëmbim, qoftë edhe kur fiton në një lojë dominoje. Avdiut i vinte inat që rrëzimi i çatisë nuk ishte bërë problem i madh. Duhej dënuar shkaktari dhe duhej dënuar rëndë.

Si pasojë, Zijain e çuan në drejtimin e puni-

meve të dy brigadave, me të drejtat e një tekniku të mesmë. Kjo masë uljeje bëri që ai të ndrydhej përbrenda vetes e mendimi i tij krijues të fashitej. Deri në një farë kohe ai e kundërshtoi energjikisht propozimin e ri të Avdiut që çatitë e tjera të depove të bëra me kapriata të prisheshin dhe të ndërtoheshin me lëndë të rrumbullakët. Por argumentave të tij ju vu përballë fakti i çatisë së rrëzuar nga dëbora. Dhe ai, ndonëse qe plotësisht i ndërgjegjshëm se kishte të drejtë, u thye. Kundërshtarët e tij qenë më të shumtë. Prandaj s'i mbe tej gjë tjetër, vetëm të heshte e të zbatonte urdhërat.

Dimri i atij viti u bë shumë i egër. Aty nga fundi i muajit mars ra dëborë pesë ditë rresht. Zijai, i shqetësuar për fatin e depove, kërkoi të dërgohejshin disa punëtorë që ta largonin dëborën nga çatitë. Drejtoria e ndërmarrjes nguronte. Edhe për një punë kaq të thjeshtë, që varej plotësisht në kompetencat e tyre, ata kërkonin aprovimin e ministrisë. Në fakt, nga ministria erdhi një aprovim i tillë, por inxhinier Avdiu ja ndaloi atij lejen e kalimit për në drejtorinë e ndërmarrjes së ndërtimeve.

Pas kësaj pritej lajmi i shembjes së depove të tjera. Avdiu i holloi duart së fërkuari. S'do të guxonte më njeri të bënte qoftë edhe ndryshimin më të vogël në projektet e hartuara prej tij. Por ai lajm ka harruar të vijë edhe sot e kësaj dite. Kapriatat e çative të lidhura me besa-besë njëra me tjetrën qëndrojnë të paepura. Shoqja e tyre që pësoi fatkeqësi pat qëlluar me kockë të dobët, të paformuar

plotësisht. Ky fakt shërbeu që çatitë e depove të mbeteshin ashtu siç qenë.

Në detyrën e re si teknik zbatimi, inxhinier Zijai vërente edhe të meta në projektet, por nuk bënte propozime për ndryshimin e tyre. Vazhdonte të zbatonte urdhërat dhe udhëzimet e dhëna nga lart. Pas orarit të punës, mbyllej në dhomën e tij, lexonte literaturë teknike, i lindnin në kokë lloj-lloj ide të reja, por që detyroheshin të ndrydheshin brenda tij. Kurajua për të krijuar, kishte mbetur si guri nën hije. Sa do të vazhdonte kështu?

Nga ana tjetër, jeta midis punëtorëve ja largoi disi atë zymtësinë që fiton njeriu që merret vazhdimisht me punë zyre. Zijai afrohej shumë me njerëzit e thjeshtë, por sidoqoftë kohën më të madhe ai e kalonte mbi projektet dhe punëtorët i shihte e i vlerësonte më tepër si zbatues të udhëzimeve dhe projekteve të zbërthyera prej tij. Kurse rënja në kontakt të drejtpërdrejtë e të vazhdueshëm me ta bëri që t'i hiqej drojtja intelektuale. Punëtorët s'ja përtonin t'i thoshin kur dilnin nga puna:

— Hajde të pimë një gotë! — Ose: — Sonte bëj gati ca djathë, ca qepë dhe një shishe raki, se do të vijmë nga dhoma për darkë.

Një mbrëmje dhoma e tij u mbush nga zhurma e dhjetë punëtorëve që i shkuan për darkë. Ai i priste dhe qe pregatitur disi. Pat blerë pak raki dhe pak meze. Por ata erdhën shumë. Ai as vend nuk kishte ku t'i vinte që të uleshin të gjithë. Ata gjetën vend vetë. Me vete kishin sjellë raki e meze jo për dhjetë, por për njëzet vetë. Atë mbrëmje Zijai do ta mbajë mend tërë jetën.

Biseda filloi rreth gjërave më të përgjithshme, rreth kohës që po mbante mirë, vazhdoi rreth fur-

nizimit të materialeve të ndërtimit që nuk shkonte paralel me mobilizimin e punonjësve. Dhe u duk sikur të gjitha u thanë e biseda mbaroi. Pikërisht në atë kohë, usta Minai, më i vjetri i punëtorëve, ju drejtua Zijait:

— Ti shoku inxhinier, sikur nuk je më ai i pari!

— Unë e di që e kemi shok të mirë, por këto kohët e fundit e ka humbur një çikë — tha tjetri.
— Po do t'i kalojë, jeta kështu e ka: herë të hedh e herë të pret.

— Të lutem shumë, Tafil — kërceu Minai — mos ma ngatërro fillin e muhabetit! Unë ta lashë radhën e fjalës ngaqë kujtova se do të më ndihmoje. Ç'kuptim ka ajo «do t'i kalojë»? Mbushe mendjen top, or babaxhan, se ky miku ynë ka rënë në mpirje. Dhe kjo lloj sëmundjeje nuk shërohet dot pa inxheksione të forta. Po kush do t'ja bëjë inxheksionet këtij, do të thuash ti. Ja, ne që e kemi shok do t'ja bëjmë. Nuk bën kështu, more shoku Zija! Ç'është kjo leqendisje që të ka mbërthyer? Ti ke qenë i palodhur, shembull të mirë na ke dhënë, na ke frymëzuar. — Usta Minai e shkundi çibukun në taketuke, shikoi përreth e vazhdoi: — Unë, shokë, nuk e pëlqej fjalën e Tafilit: «Jeta të hedh e të pret».

— Ashtu është — e rrëmbeu përsëri Tafili. — Jeta...

— Jo, nuk është ashtu, dhe të lutem shumë mos më ndërpre! Sipas fjalës sate, jeta është lumë i rrëmbyer dhe ne ashkla druri. Kështu që ne jemi lumi dhe ne i flakim lëvozhgat. Mua më dëgjo, mor inxhinier evlati, se unë kam parë më shumë se ti. Unë i kam qëndruar jetës atëhere, kur të

kafshonte tjetri në zverk dhe ti kujdeseshe se mos ju vranë dhëmbët. Këto kisha — përfundoi usta Minai. — Të pafshim më me zemër! Gëzuar!

— Hajde gëzuar, gëzuar — thanë të gjithë. — Për shëndetin e shokut Zija!

— Gëzuar qofshi të gjithë! Shëndet për ju! — tha Zijai. — Jua paça hua! Më erdhët e më gëzuat! Më kënaqët! Dua të të kthej një përgjigje, xha Mina. Fjala jote ka urtësinë popullore. Por dijeni, shokë, se unë nuk kam ndryshuar, nuk jam mpirë, ashtu siç mendoni. Dua që të flas hapur me ju. Unë nuk i nënshtrohem jetës, por janë disa çaste që të detyrojnë të heshtësh. Ja, më thoni ju, si të veproj? Gjithë forcën, dijen time nuk ja kam kushtuar vetes, por shoqërisë. Ju më njihni, e dini si kam punuar. Gjithashtu e dini edhe si u vlerësua kjo punë nga ata që janë më lart se unë. Tani folë, xha Mina, nga ta kap e si të veproj?

— Dhe pastaj thua që nuk ke zënë të mpihesh — ja rrëmbu fjalën nga goja Besimi, një mura-tor rreth të tridhjetave. — Po ti je çarmatosur fare, more shok! Mblidhi forcat, se i ke shpërndarë dhe hidhu në sulm! Po u theve në sulmin e parë, pre-gatit më shumë forca për të dytin, sulmo për herë të tretë, të katërt, të dhjetë, të njëmbëdhjetë, derisa të fitosh! Pse, si e kujton socializmin ti, meze e raki si këto që kemi sot mbi tavolinë?

— Hajde, gëzuar për socializmin që ndërtohet me vështirësi, por është i bukur! — tha një tje-tër.

— Unë do të vazhdoj, aty ku ndaloj Besimi — u fut përsëri në bisedë usta Minai. — Socializmi është i vështirë për t'u ndërtuar. Po ta përsëritësh me vend e pa vend këtë shprehje, të mos thello-

hesh në kuptimin e saj, këto fjalë mbeten të tharta, bëhen të mërzitshme. Cilat janë këto vështirësi? Luftë janë, more shokë, luftë. Unë do t'ju tregoj ç'kam mësuar nga jeta ime, se nga shkolla pak kam mësuar. Më 1942, në gjithë krahinën tonë prej njëzet e dy copë fshatrash, ishim vetëm dy komunistë. Më falni, shokë, se mbase ju duket si mburrje, por ne të dy ngritëm në këmbë një krahinë të tërë. E ç'dinim ne atëhere, shumë pak dinim, po e bënim propagandën e partisë: «O burrani, o djema, t'i përzëmë pushtuesit e t'i zhdukim tradhëtarët!» Hidheshim vetë përpara dhe na ndiqnin pas me qindra. Për ne atë kohë qe e mjaftueshme thirrja: «O burrani, o djema!» Pa provoje ta bësh propagandën e partisë edhe sot në atë mënyrë. Bëje, në qoftë se dëshiron të të qeshin...

Të gjithë dëgjonin në heshtje. Inxhinier Zijai pat mbështetur bërrylet mbi tryezë dhe pëllëmbët në mjekër. Me sy vështronte usta Minanë që e kishte përballë, ndërsa me mendje ndërgjegjen e tij.

— ... sapo mbaroi lufta, më caktuan drejtor të ndërmarrjes që merrej me rindërtimin e urave, rrugëve dhe ndërtesave të prishura nga lufta. Merreni me mend, unë drejtor. Gjithë jetën ma kishte vrarë supin rripi i torbës me veglat e muratorit (mender mjeshtrit), siç na quanin. Si e prita drejtor-llëkun, do të thoni ju. Me qejf të madh e prita. Po kush tjetër do të bëhej drejtor atëhere?! Shokun tim, me të cilin filluam lëvizjen, e rrëmbeu lufta. Dhe ja fillova:

— O burrani, o djema, ta ndërtojmë këtë urë sa më parë! O burrani, o djema, ta ndreqim këtë rrugë! O burrani, o djema, ta ngremë këtë shkollë!

Por kishte edhe njerëz që na sabotonin. Dhe vazhdoja: — O burrani, o djema, t'i ngrehim një gjyq këtij pizevengu, që na prishi punë. Po djemtë zunë të mësonin. Punët po shtoheshin dhe punët donin shkollë. Unë mbeta me «O burrani, o djema!» Dhe ma hoqën drejtorllëkun. Vendin tim e zuri një djalë me shkollë. Më vinte inat. Pëlçisja. Por ndryshe inati e ndryshe takati. Dhe zura të mësoja. Mësoja gjithë natën me kandil e me qiri. Më bëheshin sytë si kokrra dardhe nga të lexuarit. . .

. . . Një ditë shkova në komitetin e partisë e u thashë: — Ja, unë kam mësuar tani, kam mësuar shumë, përse nuk më vini drejtor? . . .

Gotat e rakisë dhe pjatat e mezeve qenë harruar sipër tryezës dhe askush nuk kujtohej për to. Usta Minai, duke treguar, po rijetonte ato vite shumë të rëndësishme të jetës së tij. Fragmente të asaj jete ai po u lëshonte shokëve përpara dhe ata i rrëmbyen ato fjalë si ushqimin më të mirë të asaj mbrëmjeje. Zijai mundohej të futej me të gjithë qenjen e tij në rrjedhën e atyre viteve të atij burri me fytyrë tërë rrudha e me flokë të thinjur. Në ato çaste ai po i bëhej më i njohur, më i afërt. . .

— Dhe e dini si më thanë në komitetin e partisë? — vazhdoi usta Minai. — Duhet mësuar më shumë. Atëhere ju futa më me ngulm leximit të librave. Studjoja me vëmendje, por askush nuk po më thërriste të më komunikonte emërimin drejtor. Siç duket, s'kisha mësuar sa duhej. Më vonë e kuptova. Nuk duhej të mësoja që të bëhesha drejtor, por t'i shërbeja shoqërisë, për të ndërtuar socializmin, sepse socializmin nuk e ndërtojnë vetëm drejtorët, por të gjithë. Këtë unë e kuptova duke mësuar e duke punuar. . . Po të dija atëhere kaq, sa

di tani, mbase për atë kohë do të isha një drejtor i mbaruar... Kurse tani... jeta ka ecur shumë përpara, more shokë. Dhe kësaj ecjeje përpara duhet t'i përgjigjemi dhe t'i përgjigjemi aty për aty.

E mbushi edhe një herë çibukun, e ndezi dhe, si e thithi dy-tri herë, e lëshoi tymin shtëllunga-shtëllunga. Shokët s'ja ndanin sytë nga fytyra. Ata aq fort e patën përqëndruar vëmendjen pas bisedës së tij, sa që asnjërit s'ju dha t'ja ndizte çibukun, siç bënëin zakonisht kur mblidheshin bashkë. Duke kujtuar këtë, më vonë inxhinier Zijai mendoi se ajo bisedë nuk zhvillohej vetëm për atë.

— Më thua jani ti, shoku inxhinier, sa bën ti për të ecur njësoj me kohën, për t'ju përgjigjur ashtu siç thotë partia «flakë për flakë» kërkesave të kohës? Qysh në goditjen e parë, ti u rrëzove më gju-një. Dhe ç'është më e keqja, as që kujtohesh të ngrihesh më këmbë; të ngrihesh e të hidhesh në sulm, të sulmohesh ashtu siç tha Besimi pak më parë. Ne duhet të mësojmë nga shokët më të ditur, nga inxhinierët dhe inxhinierët duhet të mësojnë nga praktika, nga përvoja jonë. Por mësimin duhet ta kërkojmë, duhet ta ndjekësh, ore shoku inxhinier, nuk të vjen vetë... Hajde gëzuar — tha duke dashur të shkrifëronte shokët.

Të gjithë kapën gotat.

Dhoma ziente nga bisedat. Diskutimet ishin pafund.

Si ikën shokët, Zijai e ndjente përsëri praninë e tyre. Ata me gjallëri erdhën, me gjallëri ikën dhe prapë gjallërinë e lanë brenda në dhomën e tij. Ja, vendi ku që ulur usta Minai. Dukej sikur aty ishin të gjalla fragmentet nga jeta e tij, copëzat e vogla nga ajo jetë e madhe. Ja edhe vendi i Besimit.

C'kishin të përbashkët ata të dy, xha Minai me Besimin? Të dy janë të njëlojtë, por jo tamam ashtu. Më saktë duhet thënë: vazhdim i njëri-tjetrit. Po ta merrje Besimin e sotëm dhe ta çoje në vendin e Minait të dikurshëm, ç'do të ndodhte? A do të mund ta kryente Besimi detyrën e drejtorit? Po, po! Me siguri, me siguri... Por Besimi nuk mendon kurrë për t'u bërë drejtor... Po sikur në vend të Besimit të merrnin Zijain?... Ç'gjë të përbashkët kishte midis këtyre të dyve?... A ishte edhe ai vetë si vazhdim i usta Minait?... Jeta ecën përpara, ecën me vrull dhe kërkon që ta ndjekësh, ndryshe kthehesh në lëvozhgë që rrjedha të nxjerr anësh...

Brigada në të cilën punonte usta Minai merrej me ndërtimin e një fonderie. Zijai me kohë kishte filluar punën për rishikimin e atij projekti, sepse i dukej diku i tepërt e diku i metë. E pat lënë mënjanë, por... Dhe ai e rifilloi përsëmbari. Projektin me vërejtjet dhe sugjerimet e paraqiti në këshillin teknik të ndërmarrjes. Ju kthye përgjigja: «Ideja interesante. Gjatë përpunimit vërehen boshllëqe. Është i domosdoshëm bashkëpunimi me inxhinierë metalurgë.»

Frazën e fundit Zijai e nënvizoi. Duhej bashkëpunuar jo me një inxhinier, por me inxhinierë, me inxhinierë metalurgë.

Tani në ndërmarrje nuk ishin vetëm tre inxhinierë si dikur. U kërkoi ndihmën shokëve. Bashkëpunimi qe i vështirë. Secili kishte mendimet e tij. Dhe këto mendime duheshin unifikuar në një të vetëm. Përveç kësaj, për inxhinier Zijain ky bashkëpunim pati edhe një vështirësi tjetër. Nuk është e lehtë të thuash «e bëme ne», kur je mësuar të

thuash «e bëra unë». Të mos harrojmë këtu, sepse qe ai inisiatori i rishikimit të atij projekti.

Pas pune kalonte një pjesë të mirë të kohës me punëtorët. Miqësinë më të madhe e zuri me usta Minain. Në shtëpinë e tij hynte e dilte si njeri i afërm, si shok pune i të zot të shtëpisë. Këtu i ndodhi diçka që e vuri në pozitë të vështirë, e bëri të lëkundej, e brejti ndërgjegja. Ra në dashuri me vajzën e mikut të tij të ngushtë. E dënonte veten për këtë, vendoste të mos shkelte më në atë shtëpi, derisa ta harronte atë dashuri. Kurse të nesërmen shkonte po atje, më herët se më parë, thujse e çonin vetë këmbët, pa pyetur se ç'mendime, ç'lëkundje, ç'dyshime i vërtitëshin në kokë. Prandaj ja tha hapur Minait:

— Unë dashuroj vajzën tënde.

— Si?! — Plaku u hodh përpjetë, si të kishte plasur aty ndonjë predhë. — Jazëk të qoftë! Unë të kam futur në shtëpi njësoj si djalin tim!

— Unë dhe Merita u dashuruam, xha Mina!

Plaku mbushi çibukun në heshtje dhe u largua duke tundur kokën.

Në darkë thirri shokët e brigadës në shtëpi. Bashkë me ta festoi fejesën e së bijës. Pas disa kohësh Zijai u emërua shef i planit të ndërmarrjes. Kur ju komunikua ky emërim, ju kujtua Minai i dikurshëm që mësonte me ngulm si e si të bëhej drejtor. Jeta është e mbushur me kontradikta të mëdha e të vogla. Ç'qëllim kishte? Për të punuar në shërbim të shoqërisë apo për të hipur në pozitë?

Po ai, inxhinier Zijai, në ç'anë qëndronte? Ai i shërbente dhe do t'i shërbente ndershmërisht shoqërisë, kudo që do t'ja caktonte detyrën shoqëria...

Inxhinier Avdiu u transferua nga ministria dhe erdhi në ndërmarrjen e ndërtimit të qytetit. Sipas fjalëve të tij, kishte ardhur për përforsim kuadri. Askush nuk i tha se kishte ardhur ndryshe. Nuk qe më ai Avdiu i parë, i krekosur e kapadai që i vërente kolegët nga lart-poshtë. Të paktën kështu e hiqte veten. Ju caktua detyra e të ngarkuarit nga ndërmarrja për dorëzimin e objekteve. Deri në një farë mase në këtë drejtim puna ecte mirë. Kjo e bënte që në çdo mbledhje, natyrisht me mjeshtëri, të nxirrte në pah «punën e organizuar e sistematike» të bërë për dorëzimin e objekteve. Shpeshherë shefi i planit i tërhiqte vërejtjen dhe e kritikonte për mungesë inisiative dhe zvarritje të kota, për disa ndërtesa që mund të dorëzoheshin para afatit të caktuar në grafik. Ai e mblidhte, e ruante inatin derisa të vinte çasti i përshtatshëm. Inati që mblidhet në mendje, do ta gjejë rrugën e shpërthimit në ndonjë rast, siç gjen vendin e daljes në sipërfaqe të tokës ujët e mbledhur në brendësi të maleve nga shirat dhe dëbora e shumtë, gjatë dimrit.

Konflikti ndërmjet tyre mori trajtë të hapur në rastin e plasjes së ballkonit.

Zijai donte t'i trembte këto mendime, por ato i ngjiteshin si hije. Cili ishte shkaku i vërtetë i lindjes së konfliktit midis tyre? Tek e fundit, ç'qëndrim do të mbante Zijai ndaj Avdiut, në qoftë se për herë të parë do ta njihte në rastin e plasjes së ballkonit të katit të katërt? Në bazë të këtyre pyetjeve qëndronte kontradikta midis veprimit e ndër-gjegjes. Zijai qe i ndërgjegjshëm në veprimet e tija. Po ç'ishin ato pyetje që ja sulmonin trurin pa-pushim? Ç'ishte ajo brejtje e ndërgjegjes? Apo mos

qe kjo një keqardhje që inxhinier Avdiu mbeti i gozhduar keqas në mbledhjen e asaj dite? Sidoqoftë mendimi i tij qe i prerë: Avdiu ishte përpjekur me të gjitha mënyrat që t'u ngarkonte punëtorëve të meta dhe të gjitha këto i bënte nga dëshira për të dalë vetë i larë. E pastaj? Pastaj u thye. Qe e natyrshme që do të thyhej. Ku ishte deri atëhere ai inxhinier i ngarkuar nga ndërmarrja për dorëzimin e objekteve? Një ditë më parë ai vetë kishte raportuar në drejtori se godina qe gati për dorëzim. Përse ndryshoi qëndrim kur doli me defekt? Të plasurat duhen mbyllur sa janë të vogla se pastaj nga një e plasur dalin të tjera. Zijai ecte me këto mendime. Po ç'anë do të merrte Avdiu në të ardhmen? Këtë do ta tregonte ai vetë me punë.

* * *

Ballkizja vinte rrotull nëpër shtëpi. Hynte në kuzhinë, hapte me radhë sirtaret e bufesë, i mbyllte me nervozitet; ecte me hapa të shpejtë e rrëmbyeshëm në dhomë, hapte e përplaste kanatet e dritareve, pa mundur ta kuptonte plotësisht përse vepronte në atë mënyrë. Priste të shoqin. Vështronte me inat orën, sikur ajo të qe shkaktarja e nxitjes së padurimit të saj. Kur akrepi i minutave kalonte një numër dhe i drejtohej tjetrit, shqetësimi bëhej i papërmbajtur. I dukej gjithnjë e më tepër se i shoqi kushedi ku kishte vajtur (mbase pinte me dikë në klub; kështu e kanë burrat), ndërsa ajo e priste dhe tryeza e shtruar mbetej e papërfillur.

Dhe ajo shkonte sa nga dritarja e kuzhinës te

dera e ballkonit të dhomës, shikonte me radhë kalimtarët në rrugë; sytë e saj kërkonin midis tyre fytyrën e Avdiut të saj, ecjen e tij të krekosur, kostumin kafe me jakën e këmishës sportive hedhur sipër xhaketës. Më në fund ja kapi syri. Ai ecte me nxitim, si të ngutej që të mos vonohej në një takim të rëndësishëm. Ajo shkoi t'i hapte derën me mendimin që ta pyeste dhe në të njëjtën kohë ta qortonte për vonesën, gjë jo e zakonshme për të. Por ai harroi ta përsëndeste, bile la mënjane edhe buzëqeshjen, të cilën Ballkizja ja kërkonte çdo ditë. Sytë e tij qenë thelluar, si të kishte dy net rresht pa gjumë. Dhe ajo në shenjë zemërimi u tërhoq pranë dritares, duke shikuar lëvizjet e njerëzve nëpër rrugë.

Avdiu hyri në dhomë të hiqte kostumin e të vishte pizhamat. I hodhi një vështrim si pa interes dhomës së pastër e të rregulluar me kujdes.

Ballkizja vështronte nga dritarja, ndonëse i ndjeu hapat e të shoqit. Kur hyri në kuzhinë, ajo nuk e ktheu kokën që ta ledhatonte me qerpikët e zez të kthyer në trajtë çadre.

Avdiu ishte i lodhur, mund të themi i dërmuar nga tronditja e asaj dite. Tryeza e shtruar me gje-llët e drekës ja nxitte më tepër dëshirën për të ngrënë, por qëndrimi zemërak i së shoqes e pengoi të ulej në karrige. Fustani rozë me mëngë zhapone i mbërthyer pas trupit të saj të derdhur ja çoi mendimin më pranë së shoqes, të vetmit njeri në shtëpi. Për një çast ai e harroi tronditjen e madhe të asaj dite. I vajti pranë dhe e kapi për supesh:

— Kizi, ç'ke kështu sot?

Ajo vazhdonte të vështronte nga dritarja dhe ja ktheu gjithë mllëf:

— Posi! Ç'kam! Ti ç'ke? Detyrohem të të pres
kaq shumë dhe, kur hap derën, ndodhem përballë
buzëve të tua të varura dy pëllëmbë!

Tashmë u kujtua se marrëdhënjet e koklavitura
dhe ngatërresat në punë duhen harruar kur kthe-
hesh në shtëpi. Dhe e ftoi me një ton pajtues, pothu-
ajse lutës:

— Hajde, ulu të hamë bashkë!

— Njeriu ka më shumë nevojë për përkujdesje,
dhe pse jo, edhe për përkëdhelje! — tha ajo.

Ai kujtoi se në vitin e parë të martesës e kishte
bërë rregull që, kur kthehej nga puna, ta puthte të
shoqen.

Por ngjarjet e ditës ja kishin pushtuar gjithë
trurin. Ndjenja e dobësisë ndaj së shoqes pothuajse
u fashit fare. Si për të kapërcyer tundimin, dridh-
jen e muskujve, u ul në karrige, këputi një kafshatë
të madhe buke dhe nisi të bluante duke i shtrën-
guar dhëmbët fort, saqë i kërcitën.

Ballkizja ju afrua, e shikoi në bebe të syrit me
çudi. Tani qe ajo që bëri pyetjen:

— Adi, ç'ke kështu ti sot?

Avdiu eci nëpër guzhinë me krahët të lëshuar.

— Shumë të këqia kam. Ballkoni që u dizar-
mua mbrëmë me urdhërin tim kishte marrë të plasur.

Ajo u çudit kur dëgjoji se shkaku i gjithë asaj
tronditjeje të të shoqit ishte një e plasur ballkoni.

— Si, paska plasur ballkoni?! S'është ndonjë e
keqe e madhe! Ata që e bënë një herë atë ballkon,
e ndërtojnë përsëri. . .

Kjo mënyrë të shprehuri ja cyti edhe më keq
nervat Avdiut.

— Mjaft! Mjaft Kizi, paç nderin, se më xhin-
dose! E ç'dashke ti më shumë të bëhet!? Ajo që

ty t'u dukërka asgjë, për mua është shumë, shumë! Të gjithë u shkrehën sot kundër meje, që nga Safeti (harronte se ajo s'e njihte Safetin) dhe deri te drejtori. Dhe ti mos kujto se je më mbrapa me këtë qëndrim që mban. Edhe ti vihesh në një radhë me ta, kundër meje.

Nga fjalët e të shoqit, Ballkizja ndjeu se s'kishte bërë mirë kur e kishte pritur ashtu, përderisa dukej qartë se ai ishte i tronditur. Megjithatë, dëshpërimin e vërtetë ajo s'qe në gjendje t'ja njihte. Dhe e shtyti më tej:

— Adi, dëgjo këtu! Unë vërtet s'e kuptoj si duhet ç'të paska turbulluar kaq shumë, por një gjë di të ta them: Kur e sheh që je kundër të gjithëve, atëhere pse s'provon të kuptosh shumicën?

— Sepse kam edhe unë të drejtën time, udhëhiqem edhe unë nga mendimet, qëllimet, arësyesimet e mia...

Ai sa vinte ziente dhe shpërthente.

Ajo për pak sa s'u pendua që e priti me aq zemërim në fillim; deshi t'i jepte një këshillë të arësyeshme. E kapi për krahu:

— Adi, shiko se qëllimet e tua s'janë të veçanta... Pastaj, duke marrë anën e shumicës, u shmangesh gabimeve.

— Mjaft, të thashë! Mjaft, dreqi e mori! Unë kam të drejtën time dhe do ta kërkoj...

Me hapa të mëdhenj iku në dhomë.

Pas pak, i veshur me kostum, u duk në korridor dhe doli jashtë.

Ballkizes i erdhi keq. «Si iku? Pse iku? Ku iku?»

Dera e hyrjes së apartamentit qe mbyllur pas tij.

* * *

Avdiu doli nëpër qytet. Ishte koha kur ndizen dritat dhe bulevardet gumëzhijnë nga gjallëria e njerëzve. Në kohën e beqarllëkut e pat preferuar shumë shëtitjen në bulevardet e qytetit. Ishin pesë shokë dhe së bashku dilnin vazhdimisht; herë nga kodrat e liqenit, herë në stadium e herë në kinema, herë në xhiro nëpër bulevard. Kishin një shoqëri të gëzuar. I binin dy-tri herë nga pallati «Ali Kelmendi» deri te Komiteti Qëndror, dhe herë pas here uleshin te kafe «Tirana» për t'u çlodhur disi dhe për të pirë ndonjë gjë.

Këto mendonte, ndërsa ecte i vetmuar midis rrjedhës së zhurmshe e të gjallëruar të njerëzve. Si nuk po takonte atë mbrëmje asnjë nga shokët, nga pesëshja e dikurshme?

Mbase edhe ata gjendeshin në biseda, nëpër vizita, të tërhequr për hunde nga gratë. Kur mësohet njeriu të tërhiqet nga dikush, në një farë çasti i vjen keq që i mungon kjo tërheqje. Ja, Avdiu po sillej e po vërtitej i vetëm në atë mori njerëzish, s'po takonte asnjë të njohur. Dikush e përshëndeti. Ja ktheu edhe ai përshëndetjen. Nuk e kuptoi kush ishte ai që e përshëndeti. Si fytyrë e sillte pak në hatër, por emrin ja pat harruar dhe, sado të mundohesh, s'e sillte dot në kujtesë. Do të dëshironte ta ndalonte, të bisedonte, të rinjihej me të, mbase do të kujtonin diçka të gëzueshme, por ai që e përshëndeti qe larguar; i dukeshin vetëm supet dhe

pjesa e mbrapme e kokës, të ndriçuara nga llambat neon.

Ecte me hapa të ngadaltë, të ngathët, të plogët. Pranë kaloi një çift i gëzuar. Ai i vështroi në fytyrë. Ata i folën:

— Mirë mbrëma, Avdi! Vetëm paske dalë?

Nuk munda t'u kthente përgjigje. Fytyra të njohura, por emrat s'ua mbante mend. Ata i folën të dy në emër. Kurse ai...

Vendosi t'i shkonte për vizitë Nuriut, një shokut të tij të vjetër. Nuriu pat kryer studimet jashtë shtetit në të njëjtën kohë me Avdiun. Megjithëse studjonin në degë të ndryshme (Nuriu ndiqte inxhinierinë mekanike) qenë lidhur ngushtë. Avdiu, si tip, nuk e duronte kritikën, ndërsa ndaj Nuriut mbante tjetër qëndrim. Ai të rrihte me pambuk, si i thonë fjalës. Ishte përgjegjës i studentëve shqiptarë të atij qyteti të huaj dhe mbante lidhje të barabarta me të gjithë. Avdiu, mbase padashur, i nënshtrohej autoritetit të tij. Pasi kreu studimet, Nuriu u emërua në një uzinë të kryeqytetit, ku u bë edhe kryeinxhinier. Kohët e fundit u ngarkua me detyra partie. Avdiu vendosi t'ja tregonte çështjen e tij Nuriut. Jo aq fort për ankesë, se sa për të marrë një mendim prej tij.

— Babi, ka ardhur një xhaxhi që unë s'e njoh! — thirri vajza e madhe.

Nuriu po studjonte disa materiale. E shoqja gatuate në kuzhinë.

— Oi, kush paska ardhur! Po çfarë të kthejmë përmbys, more Avdi, çfarë të kthejmë? Po gjallë qenke, a lumëmadh — tha Nuriu duke hequr syzet. E përqafoi dhe e shtrëngoi fort. — E shikon, t'i krisa kockat. — Qeshën të dy.

E shoqja erdhi nga kuzhina, fshiu duart e lagura dhe u takua përzemërsisht me mysafirin. E vunë në mes. Tri vajzat u mblodhën përreth. Avdiut i vërshoi një ngrohtësi në trup. Ç'erë e ëmbël frynte në atë familje të bukur prej pesë vetësh! Avdiu që i praktikuar në vajtjet për vizita dhe e dinte sa rëndësi kishte të sjellurit me etiketë në të tilla raste. Kurse në atë shtëpi...

— Liroje kravatën, hiqe xhaketën dhe rri lirisht — tha Nuriu.

Dhe ai u bind. I përkëdheli vajzat me dashuri. I erdhi keq që s'ju kujtua t'u sillte diçka. «Sa të mira!» — mendoi. Ai vetë s'kishte fëmijë.

Sadetja, e shoqja e Nuriut, solli një shishe me raki e pak meze.

— Miqve që vijnë rrallë u takon rakia — tha ajo me shaka.

Ata nuk e dinin se atë e pruri shqetësimi i tij. Kur ke një kohë të gjatë pa u takuar me ndonjë njeri, ke shumë për të folur. Por më e keqja është, kur ti do t'i thuash shqetësimin tënd, atëhere nuk di nga ta nisësh. Në këtë gjendje u ndodh Avdiu në fillim. Por rakia ja ngrohu gjoksin dhe gjuhën. Fjalët e para të tij qenë si përgjigje të shkurtëra të pyetjeve të Nuriut. Pastaj goja ju zgjidh. Respekti që ndjejmë karshi një njeriu na shërben si kapëse, ku varim shpresat në një çast, duke menduar se kemi mbetur pa mbështetje. I tha të gjitha.

Nuriu nuk e ndërpreu asnjëherë. E dëgjoi me vëmendje nga fillimi e deri në fund. Veshët kapnin çdo fjalë dhe mendja bënte interpretimin e tyre. E vërente Avdiun në majë të një bregoreje. Në atë majë ai s'e pati të vështirë të ngjitej. Mbi atë bregore ngrihen maja të tjera më të larta.

Por ato maja mbi gjithshka duan djersë. Avdiu s'e duron dot atë erë. Dhe ecën në zbritje. Dikush i bën pritë, e kthen me fytyrë nga majat. Avdiu kërkon rrugë të sheshtë për të dalë në majë. Nuk gjen. Nis të bëjë dredha, kalon nëpër zigzage. Dhe zbret, zbret... Gjen një copë rrugë të drejtë. Ecën me të shpejtë. Ngatërrohet nëpër kthesa. Dëgjon që i thërresin: «Ke humbur rrugën, hajde pas nesh!»

Nuk i pëlqen të ecë pas të tjerëve. Do që të jetë vetë në krye. Dhe zbret, duke kujtuar se ngjitet. Avdiu ngatërrohet nëpër kthesa, humbet orientimin. Papritur kujtohet se është larguar shumë. Vëren përreth. Mundohet të kujtojë shtigjet nga ku kaloi për të ardhur deri aty. Diçka kujton, por fare turbull. Atëhere, mbledh forcat, bën përpjekje të largohet, të largohet... Avdiu është mësuar t'u shmanget vazhdimisht të pjerrëtave, ngjitjeve, ose më saktë, të ngjitet pa djersitur. Duke nuhatur e duke kërkuar me çdo kusht kthesat zigzage, u është mënjanuar ndeshjeve, përplasjeve. Nuk është futur në rrjedhën e lumit të madh, është kthyer në lëvozhgë, do të thoshte usta Minai. Por lëvozhgat që dalin anësh në rrjedhën e parë, rrjedha tjetër që vjen më e furishme dhe e gjerë i përfshin e i përplas brigjeve e shkëmbenjve. Ashklat mund të notojnë vetëm në ujë të qetë. Avdiu shikon përreth. Diku është përplasur. Përballë ka gjithë rrjedhën e vrullshme...

— Sonte e ndjej që duhet të jem i ashpër me ty dhe se kam bërë gabim që të kam lëmuar dikur.

Avdiu vuri re se edhe zëri i Nuriut, ndryshe nga herët e tjera, pa prituri u bë i ashpër. Ai nuk mbante mend që ta kishte lëmuar ndonjëherë ky

njeri. Një rrëqethje i kaloi në trup, një rrëqethje që e trondiste dhe e inkurajonte në të njëjtën kohë.

— Të vijmë në rastin konkret. E zëmë për një çast se ai ballkon nuk ka të bëjë me punën tënde të drejtpërdrejtë, domethënë ti nuk mban përgjegjësi për të, po dikush tjetër. Më thuaj tani, por drejt ama, ç'qëndrim do të mbaje, do të alarmoheshe, siç je alarmuar? Më vjen keq, por po ta them troç: ti nuk do ta çaje kokën fare.

Avdiu u ngut të thoshte diçka, por i kaloi pësh-tyma keq në grykë dhe sytë i lëshuan lot padashur.

— Ke filluar të tronditesh shpejt — vazhdoi Nuriu. — Unë sa të shpova një çikë dhe për pak u mbyte. Ti nuk e quan tëndin atë ballkon. Ti quan tënden diplomën e inxhinierit...

— Ti nuk më kuptove — e ndërpreu Avdiu. — Diçka po ndodh me mua: Ose s'jam në gjendje t'i bind të tjerët për çka mendoj, ose të tjerët, meqë jam kundër tyre, s'duan të më kuptojnë. Sikur ta shpjegova pak më parë...

— Ja si të kam kuptuar. — Nuriu godiste herë-pashere me gisht në tryezë, si t'u vinte shenjat e pikësimit fjalëve që thoshte: — Ti mendon se ai ballkon u dëmtua për arsye se është betonuar keq. Dakord, mund të jetë edhe kështu...

— A, jo! Me këtë «mund» s'pajtohem — kërceu Avdiu.

— E po prit tani, të lutem shumë! — Nuriu u nxeh. — Ti çfarë do tani, që unë të zë e të bërtas pas teje: Pushoni ore! Heshtni të gjithë, binduni se Avdiu ka të drejtë!

— Fakti. Hekuri i ballkonit i shkelur, i ngjeshur poshtë.

— Epo ai hekur s'është i vetmi për ballkonin, ashtu siç nuk je edhe ti i vetmi inxhinier për ndër-marrjen. Më vjen keq që po ta them: ti duhet ta dish se projektesi e ka pasur parasysh edhe ndonjë pakujdesi të tillë. Parashikohet në projekt, për she-mbull, që ballkoni të përballojë më shumë nga sa është pesha e llogaritur. Është kështu apo jo?

— Kështu është, por shkeljet nuk lejohen.

— Mirë, e llogaritët ju peshën e dërrasave që ranë sipër ballkonit?

— Nuk e di. Zijai seç bëri...

— E shikon pra, ti qëndron larg thelbit të çësh-tjes, vërtitësh anësh. I ndam punët: kjo imja, kjo e Zijait...

— S'do mend gjithsecili përgjigjet për detyrën e tij...

— Dhe natyrisht, por jo duke lënë mënjanë të përgjithshmen.

— Në qoftë se secili e kryen në rregull detyrën e tij të veçantë, s'ka pse të mos jetë në rregull edhe detyra e përgjithshme.

— Tani dole atje ku duhet të kishe dalë me kohë. Tamam siç të thashë pak më parë. Ti shqetë-sohesh për ballkonin vetëm sepse ai plasi. Dhe e bën këtë ngaqë ndërtesa s'është marrë në dorëzim. Pastaj, veten vraftë ai njeri që përgjigjet për të. Ty të mjafton vetëm të jesh në rregull nga ana e jashtme.

Avdiut s'po i vinin dot mendimet për ta kundër-shtuar Nuriun. Pak a shumë në një formë të tillë u shtrua problemi edhe në mbledhjen e asaj dite.

Në tryezë u ul Sadetja.

— Besoj se më pranoni edhe mua — u fut në bisedë ajo.

— Me gjithë qejf. — Avdiut i doli përpara skena e grindjes me të shoqen. Kohë më parë u qëllonte shpesh të bisedonin për probleme të ndryshme në këtë shtëpi. Dhe ai e dinte se Sadetja kishte cilësinë të mos i lëshonte fjalët si byku i kashtës kur derdhet nga një thes i grisur.

— Merr edhe një gotë për vete — i tha Nuriu së shoqes.

— Hajde gëzuar — uroi Sadetja. — Avdi, të lumshin këmbët dhe na ardhsh më dendur, por jo vetëm.

«Eh, si kam ardhur sontel!»

— U hëngrëm ca me fjalë deri tani me Avdiun...

— Dëgjova diçka ndërsa merresha me vajzat. Por ju bisedonit, nuk grindeshit.

— Sapo filluam... — tha Avdiu.

— Jo, kemi filluar me kohë; qysh kur ti nise të më tregoje shqetësimet e tua. — Nuriut s'i vinte mirë që me ardhjen e së shoqes biseda të zhvillohej e lehtë, të merrte një ton të qetë familjar.

— Po më lini radhë edhe mua — tha ajo. — Ju mendoni ndryshe nga shoku-shoku. — Ajo i shikoi me vëmendje të dy. — Secili gjykon si për vete. Ti, Nuri, s'duhet t'i imponosh Avdiut me forcë mendimin tënd. Ai mbase ka vërtet të drejtë...

— E vetmja fjalë përkrahëse që dëgjoj sot — tha i lehtësuar Avdiu.

— Mos kapemi pas vogëlsirash. — Nuriu donte të ishte i prerë. — Shoqëria që kemi me Avdiun s'na pengon t'i themi hapur: studjoje mirë veten, punën tënde, vëre në balancë me shokët, nxirr mësimet...

— Po kur shokët s'kanë të drejtë? — tha ajo.

Sadetja e kuptonte ku qëllonte i shoqi. Ajo tërthorazi donte t'i jete Avdiut të kuptonte se, duke qëndruar larg shqetësimit të përgjithshëm, njeriu veçohet, mbyllet, ndrydhet, e mban shikimin vetëm në një drejtim.

— Hë, këtu është kyçi. — Nuriu i doli përpara shokut. — Të dish t'i çmosh shokët. Edhe unë i bëj vetes këtë pyetje: pse njerëzit tanë me qëllime të njëjta, me të drejta të barabarta në shoqëri, me kulturë pak a shumë të njëjtë, kanë rezultate të ndryshme në jetë? Ja ku kemi rastin e sotshëm. Kundër njëri-tjetrit dalin Zijai dhe Avdiu. Ti, Sadete, nuk e njeh Zijain. Unë kam pasur raste të punoj me të, kur u ngrit fonderia e uzinës. Është një djalë shumë energjik. Të dy këta janë nga një krahinë, kanë mësuar bashkë në shkollë. Pse ndodhi në rastin e sotshëm që Zijai është i mbështetur nga të gjithë, kurse Avdiu i veçar?

— I bashkon faji i përbashkët — u hodh Avdiu.

— Ndryshimi s'duhet të jetë i çastit — theksoi Sadetja. — Shkakui i vërtetë duhet të jetë më thellë.

— Zijai është si një pemë e zhvilluar nën mbikëqyrjen e pemërritësve — vazhdoi Nuriu. — I është krasitur çdo degë e tepërt. Kurse Avdiu s'ka ndërje sëpatë (kritikë të ashpër). Ndoshta fajtor s'është këtu vetë Avdiu, por edhe rrethanat, natyra e punës së tij.

Avdiu vështronte mbi tryezë, pa i përqëndruar sytë në një vend. Ndjente se s'kish fuqi të shikonte as Nuriun as edhe Sadeten. Krahasimi midis tij dhe Zijait ja acaronte nervat aq fori sa, të mos qe turpi, mund të ngrihej e të ikte. Kjo ndjenjë. si

qe ndarë gjithë ditën: të mos ndalej në vend, të ecte. Nevojën për t'u larguar e kishte edhe në mbledhjen e asaj dite, edhe në grindjen më të shopen, edhe tani në bisedë me Nuriun. Mbase arësyeja e vërtetë qenë tehat e mprehtë të kritikës, të kundërshtimit që s'i ndahej. Një gjë e tillë vërehet te kau, kur e pickon idhshëm zagali.

Nuk e kundërshtoi më Nuriun dhe qëndroi aq kohë, sa të mendonin se nuk kishte ikur i zemëruar prej shtëpisë së tyre.

Yjet, lart në kupën e qiellit ngjanin si të ngatërruara e të pleksura midis njëri-tjetrit. Kashta e Kumtrit shembëllente me një të plasur midis qiellit, si një vijë e bardhë, e gjerë, e shënuar në hapësirë. Një fillad i lehtë e i nxehtë lëkundte ngadalë gjethet e pemëve anës bulevardit.

Avdiu ecte mendueshëm. Zhurma e hapave të tij përzihej me trokëllimën e kalimtarëve të rrallë, të vonuar. Në të dyja anët e rrugës ngriheshin ndërtesa të larta, shumica të reja. Në projektin e këtyre ndërtesave ishte puna edhe e dorës së tij. Ato do të mbeteshin të përjetshme, edhe brezat pasardhës do t'i shikonin me respekt. Një pjesë e këtij respekti pa tjetër i takonte Avdiut. Por ky respekt s'kishte si të veçohet e t'i përkiste vetëm atij me emër: ky është për inxhinier Avdiun. . .

Këmbët ecnin thujse vetëvetiu në rrugën që çonte për në shtëpinë e tij. Në të dyja anët e asaj rruge ndërtesat ishin krejt të reja, të viteve të fundit. Ai vetë kishte firmosur aktet e dorëzimit të tyre. Dhe tani ecte i menduar, i heshtur. Kush i kishte ndërtuar ato godna, ato ballkone të mbushura me vazo lulesh, qindra ballkone?! Në vazhdim të atij blloku të ri ndërtesash një godinë ishte në ndërtim

e sipër. Atje po punohej edhe natën. Betonohej. Te veshët e Avdiut vinte zhurma e zërave të punëtorëve, e veglave të punës dhe, mbi të gjitha, zhurma e vibratorit. Vinçi «Pionier» ngrinte kovat e mbushura me beton njëërën pas tjetrës dhe heraherës i vinin në vesh të bërtitura të forta:

— Ngrije!

— Ule!

Dhe zhurma e vibratorit, që s'ndalonte për asnjë çast, duke prishur me këmbëngulje heshtjen rretheqark.

Punimet në atë ndërtesë ecnin dy muaj përpara grafikut që kishte inxhinier Avdiu në planifikimin e dorëzimit të saj...

Tani betonohej soleta e katit të katërt. Avdiu hodhi vështrimin në një vend të caktuar; te ballkoni i qoshes (i njëllojtë me ballkonin e plasur), tekniku, Anastasi, ngjishte betonin me vibrator.

Avdiu u kthye dhe shikoi prapa. Në gjithë atë rrugë ai ishte kalimtar i vonuar.

I lindi një mendim i çastit: të rendte me vrap, të ngjitej në katin e katërt të godinës ku bëhej betonimi, të merrte një lopatë nga të punëtorëve, të rrëmbente vibratorin e Anastasit.

... I erdhi si buçitje një e qeshur, si kor i për-bashkët, si brohoritje. Qeshnin punëtorët, sigurisht me ndonjë shaka të lëshuar shpejt e shpejt midis shokësh, gjatë punës...

... Deshi të shkëputej nga grindja me vetëveten... Po i afrohej shtëpisë. Do të qe më mirë që rruga të zgjatej, të zgjatej dhe ai të ecte, të ecte. Këmbët pothuajse vetë morën kthesën. Në apartamentin e tij dritat qenë fikur. Nga ballkoni piko-

nin vazot e luleve. Asaj mbrëmjeje i mbetën sytë nëpër ballkonet.

PARA SE TË FILLOJË VAPA

Drita e mëngjezit, duke depërtuar në hapësirën midis perdeve nejloni e damasku i ra mbi sytë gjysmë të hapur. Shikoi orën, pesë e gjysmë. Pranë tij e shoqja vazhdonte të flinte e qetë. Qerpikët e zez, të kthyer në trajtë çadre shtrënguar fort njëri me tjetrin, sikur donin të mbronin sytë e bukur nga depërtimi i dritës.

Avdiu u ngrit. Vishej ngadalë që të mos bënte zhurmë. Stilografi i ra nga xhepi i xhaketës. Ai e flaku me forcë mendimin se mos u thye stilografi dhe shikoi se a po hapeshin qerpikët.

Qerpikët u hapën. Ajo u shtriq dhe me zë gati si belbëzimë foli:

— E theve?

Avdiu e ngriti stilografin. S'qe dëmtuar.

Ballkizes ju dhimbs, kur e pa ashtu, me sytë të fryrë.

«S'ka fjetur... Është i shqetësuar... Dhe unë u grinda mbrëmë...»

— Prit, të të bëj një kafe, Avdi.

Kur doli jashtë, qyteti sapo merrte gjallëri, njerëzit vërshonin nga drejtime të ndryshme.

— Hajde, llustra, boja gati — i thirri lustraxhiu duke trokitur furçën pas mbështetëseve të këpuçeve.

Avdiu shikoi këpucët. Qenë bërë me pluhur. Kohë kishte, prandaj bënte mirë t'i bojatiste.

— Prej nga të kemi? — e pyeti lustraxhiu, me të filluar nga puna.

— Nga ky qytet jam.

— Ashtu?! S'të kam parë.

Avdiu detyrohej të jepte përgjigje, e pamundur të mbetej pa bërë muhabet te lustraxhinjtë e berberët.

— E po, qytet i madh, dyqindmijë banorë. Ku mbahen mend të gjithë, sa fytyra shikon.

— Ashtu është xhanëm. Ku e ke shtëpinë ti? Banorët e kësaj mëhalle pothuajse i njoh krejt.

— Banoj në një lagje tjetër.

— Ashtu?!

Avdiu nxori paqetën e cigareve, ja zgjati lustraxhiut për të shpëtuar sadopak nga pyetjet.

— T'u rritë nderi — tha tjetri, duke marrë cigaren. Dhe si e ndezi: — Çfarë pune bën ti?

— Inxhinier.

— Shumë mirë, të njoha nga këpucët. Asnjë njollë. Po ku punon?

— Në ndërtim.

— Ashtu?! Shumë mirë, shumë mirë! Ama ta them në sy. Ka ankesa për ju të ndërtimit. Ja, unë jam i pari. Jam ngushtë me shtëpi, more vëlla. Nuk isha keq, xhanëm, po ç'ti bësh. Kam një çun, i ri kopili, tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë vjeç, pa kryer ushtrinë akoma. U sev dallis me një vashëzë, moshataren e vet dhe ma pruri në shtëpi, më zuri kornakun. Mua me plakën na qitën në kuzhinë. Ata të lagjes më mbajtën me shpresa se do t'u dorëzoka një pallat katër katesh. Kur dje dëgjuaam se atij pallati ju ka shembur një ballkon e s'dorëzohet as për një muaj. Prandaj them unë që ka ankesa për ju të ndërtimit. Ja, unë jam i pari. Ti qenke dhe

inxhinier... Di gjë ti për punën e atij ballkoni?..

Avdiu u ngut të paguante dhe iku pa i lustruar plotësisht këpucët.

«Sa shpejt merret vesh, kur ndodh një e keqe... Edhe lustraxhiut duhet t'i japësh ilogari... S'ke ç'i bën, problemi i strehimit, çështje e të gjithëve...»

Ai vetë ishte mirë me shtëpi.

Orari zyrtar fillonte pas dyzet minutash. Ishte nisur herët. S'i rrihej në shtëpi. Nuriu i dha një dush të fortë mbrëmjen e kaluar. Dhe ai u thye. Mbase që ky një çast dobësie apo gozhdimi para së vërtetës. Çast dobësie me siguri. S'mund të që ndryshe. Pse të qëndronte ai kundër së vërtetës? Apo sepse kundër tij qëndronin Zijai, Fatmiri, Safeti... Ata përfaqësonin të vërtetën? Nuk që e thënë një gjë e tillë. Përpara të dyja palëve ndodhej fakti që ballkoni mori të plasur nga një goditje e peshës së armaturës. Këtë armaturë e bëri brigada e Fatmirit. Po kjo brigadë e betanoi, kjo brigadë e dizarroi. Dhe Zijai kishte punuar një muaj në atë brigadë. Këtë kërkonte Avdiu. Të hidhej përgjegjësia mbi ta.

«Po të mos që linja elektrike pranë asaj ndërtese, mund të mos ndodhte ajo që ndodhi. Dakord, mund të mos ndodhte. Ç'na duhet të kapemi pas supozimeve tani, kur kemi faktin përpara? Po pse dhashë urdhër të prerë që të hiqej armatura? Si të veproja ndryshe? Duhej përgjigja për dorëzimin e objekteve. Kalonte afati i dorëzimit. Janë me ilogari këto punë. Më kapin mua për zverku. Mua më dhemb kur vras gishtin vetë. E si do të ndjej dhembje, kur plagën e ka dikush tjetër në trup?»

Çdo njeri ka një punë të caktuar: dikush murator, një tjetër inxhinier zbatimi, tjetri projektues, një tjetër lustraxhi... Lustraxhiu që i bojatisi këpucët Avdiut kishte nevojë për shtëpi. Ai s'qe i ngarkuar për dorëzimin e banesave, po interesohej, shqetësohej shumë për to. Avdiut për një çast ju rrëzuan mendimet e mëparshme.

Sidoqoftë. Avdiu s'kishte faj në këtë mes. Mos deshi ai të krisej ballkoni! Përkundrazi, qe në favor të tij që ndërtesa të dorëzohej një orë e më parë. Le të banonte atje, lustraxhiu e kushdo tjetër.

Tanimë ndryshonte çështja. Atij së pari i duhej të shmangej nga përgjegjësia. Por dikush do ta merrte përgjegjësinë përsipër. Kush siguronte se edhe ballkonet e tjera qenë pa defekte? Duhej bërë prova përsëri. Pa tjetër.

Meqë ishte ende shpejt për të shkuar në zyrë, vendosi me vete të kalonte një herë nga godina... Hera e parë që shkonte në objekt pa u futur më parë në zyrë. Por atë ditë e prishi rregullin. S'i durohej sa ta shihte qoftë edhe kalimthi atë ballkon. Kushedi ç'mund të kishte ndodhur gjatë natës. Natyrisht, mrekulli s'mund të ndodhte e të mbyllej e plasura. Zemra ndjell më shpejt të keqen, se sa të mirën. Dhe s'ishte çudi të shtrembëroheshin hekurat e zbuluar me daltë, të thyenin binarët mbështetës... Nuk e dëgjuan Avdiun. Ai e tha hapur mendimin e tij: të prishej ballkoni plotësisht e të niste nga fillimi. Po s'ke ç'i bën, kur s'të dëgjojnë. Kështu vete puna, kur bëhet bishti më i rëndë nga sqepari.

Ora gjashtë e gjysmë. Punëtorët e fillonin pu-

nën pas një gjysmë ore. Avdiu mund të hipte i qetë në katin e katërt.

Por s'ishte ai i pari që shkonte tek ajo godinë atë mëngjez. Nga larg njohu Fatmirin e Safetin. Po u hiqnin mbështetëset pesë ballkoneve të tjera të godinës.

«Ç'bëjnë këta të çmendur!?» Ballkonet qenë mbushur me tulla, deri rrafsh me parapetin. «Kur e paskan bërë gjithë këtë punë? Natën, me siguri natën. Aty janë gdhirë. Tani u heqin mbështetëset, për t'u siguruar nëse e përmballojnë peshën e duhur. Të fortë! Të fortë dhe të zot! Ki inat, jepu hakun. Apo e bëjnë për t'i larë sytë së keqes. Sidoqoftë...»

Dy ballkone të mbetura pa mbështetëse qëndronin për bukuri. Fatmiri diçka matte me metër. Me siguri përkuljen që merrte betoni nën shtypjen e peshës së tullave.

Avdiu u mat të shkonte ta shihte vetë. Fatmiri u ngrit me metër në dorë. Nga shenjat që i bënte Safetit (zërin Avdiu s'e dëgjonte), kuptohej që rezultati i provës ishte i mirë.

«S'bën të shkoj tani atje. Si shiu pas të vjelit». — Avdiut i erdhi mirë që s'e pa njeri. Dhe u kthye nëpër një rrugicë që të nxirrte në anë të kundërt të asaj godine. S'i mbetej më, veçse të shkonte në zyrë. Rrezet e diellit i binin mbi qafë. Megjithëse mëngjez, e digjnin. «Do të ketë shumë vapë sot». Liroi gravatën. Zbërtheu edhe kapësen e sipërme të këmishës. Ecte me hapa të rëndë. Supet i tundeshin sipas lëvizjes së këmbëve. Se ç'i rëndonte mbi ato supe! Mbase pesha e tullave e vendosur mbi ballkonet.

Mendimi «Të fortë» ju qep si hije, s'i ndahej

nga mbrapa. Rrugica ku ecte ishte e shtruar me kalldrëm, me gurë të rrumbullakët. Të tilla kalldrëme ishin karakteristike në qytetin e tij të lindjes. Ai qe mësuar të ecte gjithnjë në majë të gurëve...

Kujtimet e vegjëlisë sado çapkëne e ngacmonjëse janë, atë mëngjez nuk e kishin forcën për t'ja shkëputur dy fjalët e vetme «Të fortë».

Ecte kokëulur.

«Mos vërtet kam bërë gabim që deri tani s'e kam njohur fortësinë e tyre? Mbase duhej të ndodhte kjo e plasura që unë të vija tek e vërteta, të gjeja vetëveten...»

Nga mbrapa dëgjoi borinë e maqinës.

— Ej, shok! Nuk të nxe ana që ja ke marrë mes për mes rrugës?

Ishte shoferi i maqinës së bukës.

U hoq mënjanë. Cepi i pasmë i mushamasë që mbulohej karrocera e maqinës i ceku mëngën e xhaketës. Era e bukës ja shkundi inatin ndaj fjalëve të shoferit.

Doli në rrugën kryesore. Pas dy-tri minutash ishte në zyrë. Ju kujtuan shkresat e shumta mbi tryezë, kërkesa për godinat e ndryshme, grafikë dorëzimi, projekte. Dhe ballkoni i piasur.

«Kur do të mbarojë kjo histori? Sot e treta ditë dhe u lodha sa për tre vjet!»

Një zë e ngacmoi. «Mbase në tre vjet se ke ndjerë lodhjen e këtyre tri ditëve».

U drodh. Nga i doli ai zë? Tre vjet të punës së tij në ndërmarrje!.. Dhjetëra e qindra godina qenë dorëzuar nën kujdesin e mbikqyrjen e tij.

Në buzë ju nde një e qeshur, nga ato të qeshura që të vijnë vetëvetiu.

MBYLLET NJË E PLASUR

Ishte një pasdite me vapë të rëndë, të padurueshme. Zagushi. Retë qenë dendësuar dhe asnjë fije ere s'pipëtinte. Në ditë të tilla gjatë verës, kur nuk ka as diell e as bie shi, nxehtësia mbetet e platitur, e palëvizshme, si të nxitet nga çasti në çast të të zërë frymën.

Ventilatori në zyrën e Avdiut qe i pafuqishëm për ta freskuar ajrin. Prej lëvizjes së tij energjike e të pandërprerë krijohet vetëm një rrymë ajri gati djegëse. Sa hapte dritaren, brenda vërshonin mizat, ca miza të vogla që vërsuleshin si qorre dhe të përvëltonin mishrat me atë pickimin e tyre të pangopur.

«Dreqi e mori», murmuriti ai duke fërkuar llërët e zverkun, «edhe ju ishit mangut... Ndjellin shi të mallëkuarat... Po ku është shiu?!»

Në mes të punës, shqyrtimit të disa projekteve të reja që ja sollën atë ditë nga byroja teknike, ndjekjes së problemeve të dorëzimit të disa aparatamenteve të reja që po u afronte afati, mendimeve çapraze rreth ballkonit që ende qëndronte i plasur, hynin vapa e rëndë dhe pickimet e këtyre mizave.

«Nuk durohet». — I mblodhi shkresurinat e shpërndara mbi tryezë, i futi në një dosje «lëmsh e përsesh në një vend» dhe doli nga zyra. Atë ditë, pas orës gjashtë të mbrëmjes do të betonohej ballkoni...

Shtresa e reve të shtrënguara, të palëvizshme ngjante me sipërfaqen e një tavani të madh, të shtrembër, gunga-gunga. Pluhuri i rëndë, mbytës, tregonte se zagushia s'do të tundej derisa nga ajo

shtresë resh të zbrazeshin pikat e shiut. Mizat, grumbuj-grumbuj vërtiteshin të shqetësuar dhe të futeshin në sy si të verbëra.

«Do të bjerë shi».

Duke ecur disa hapa, i kredhur në mendime, vërejti i çuditur se dëshira për të rënë shi po i kthehej në një domosdoshmëri. «Plasëm nga vapa dhe, po të zërë shiu tani shpejt, betonimi i ballkonit do të shtyhet edhe sot».

Gjithë ato ditë, gati një javë, s'kishte dalë nëpër objektet. «Le të bëjnë si të duan. Jam i mbytur me punë në zyrë, deri në grykë. Teknikët e objekteve janë të detyruar të raportojnë rregullisht mbi zbatimin e grafikëve që u kam caktuar».

Ecte kokëulur, këpucët lëshonin një zhurmë që shkonte pa u veçuar prej mendimeve të tij. E kundërshtoi sa deshi e sa mundi betonimin e ballkonit, pa e prishur më parë gjithë pjesën ekzistuese. Pranoi të nxirrte arësytetime dhe «argumenta» njërin më të fortë se tjetrin. Këshilli teknik i ndërmarrjes ja rrëzoi. Pas kësaj s'mbetej tjetër: o burra në ministri; thirrje për ndërhyrje... Dhe më në fund u vendos që... të mos zgjatej më kjo punë...

«Mbase fillon shiu, se edhe vapa na mbyti!»

Mizat trumba-trumba i hidheshin para syve, mendimet si dengje i përplaseshin në kokë. Kush e nxori nga zyra? Mizat apo mendimet?

Duhej pa tjetër të shkonte, të merrte pjesë në ribetonimin e ballkonit. Sido që të ndodhte më tej...

Ora po kalonte gjashtën. Maqina me beton s'po vinte ende. Punëtorët po merreshin me përgatitjet. Kishin vendosur një karrukull dhe një çikrik dore. Fatmiri po lagte me ujë vendin ku do të hidhej be-

toni. Sa pa inxhinier Avdiun, ai i doli përpara dhe i tha që të kontrollonte një herë vendosjen e hekurave.

«Qerrata brigadier, i shkathët! I shkathët, apo..?»

Në atë kohë erdhi maqina e betonit. Safeti i doli përpara shoferit që t'i tregonte vendin e shkar-kimit.

— Kë ke caktuar për të bërë ngjeshjen, Fatmir? — Avdiu, me gjithë sulmin e mendimeve kundërshtuese, e kuptonte se nuk bënte të tregohej indiferent në çastin kur e shihte se gjithshka ishte kryer.

— Vetë — u përgjegj Fatmiri, ndërsa kapi një kovë me ujë që ju ngjit nga poshtë me çikrik dhe e hodhi sipër betonit ekzistues.

— Mirë, mirë, me kujdes ë! U bë ç'u bë më parë, po tani të paktën të dalë punë e saktë!

— S'do mënd, s'qe i pakët gabimi i parë...

Kovat e para të betonit u ngjitën. Një punëtor i hapte ato në qoshe të ballkonit dhe Fatmiri e rrafshonte në nivelin e armaturës.

Inxhinieri pinte cigare i mbështetur pas kases së derës dhe, ndërsa nxirrte shtëllunga tymi nga goja, lëshonte një fishkëllimë me majë të gjuhës.

Kovat e mbushura me beton ngjiteshin pa i lënë radhë njëra-tjetrës. Litari i tërhequr me forcë nga duart eshtake të Safetit lëvizte si gjarpër në të thelluarën e karrukllës, duke lëshuar një tingull gërvishës të vazhdueshëm: «Si nuk e kanë lyer me graso këtë dreq, na gërreu zorrët!»

Që nga poshtë vinte zhurma e çikrikut që rrotullohej: drëng, drëng, drëng.

«Të qe ndonjë poet këtu në vendin tim i mbështetur pas kasës së derës, do ta quante punën e sotme romantikë revolucionare».

— E shikoni si këndon çikriku, apo jo? Është i gëzuar që i qëlloi këtij t'ja vërë vulën e fundit pallatit — vinte zëri i trashë i Safetit, si zëri i një spikeri në një film dokumentar.

Fatmiri i përqëndruar dhe i kujdesshëm në kryerjen e punës, thaujse e kishte harruar inxhinierin që rrinte më këmbë te dera e ballkonit, që pinte vazhdimisht cigare dhe vërente shtresën e betonit që shtohet pëllëmbë pas pëllëmbë. E plasura e ballkonit sa vinte mbyllej, zvogëlohej. Të paktën kështu kujtonte Avdiu. Për çdo çast ndjente zhurmën e mistrisë që shtronte betonin, zhurmën gërvishëse të litarit: drëng-drëngu i çikrikut, zëri kumbonjës i punës. Papritur ju duk vetja fare i parëndësishëm në atë pleksje të harmonishme lëvizjesh energjike.

«Më helmoi dreqi», dhe e flaku cigaren përgjysmë. Por shpejt u pendua që e hodhi. Nxori paqetën dhe ndezi një cigare tjetër.

— Si shumë duhan po pi. — Fatmiri drejtoi trupin dhe e shikoi drejt në sy.

— Çlodhu pak, merre ndize edhe ti një cigare — i tha Avdiu duke i afruar paqetën.

— E kam lënë po bëj gati një muaj.

Avdiu me ngathtësi e çoi paqetën pranë xhepit të pantallonave.

— Mirë ke bërë. Është i bezdisshëm, por unë s'e lë dot. Më është bërë ves; një çikë ta harroj, më kujton vetë.

— Po vendose...

— Më duket sikur qetësohem, përqëndrohem.

— Më shumë ta shton nervozizmin, e kam pro-

vuar vetë. — Fatmiri u përkul dhe mori mistrinë. — Këtu hidhe betonin — i tha duke treguar vendin anës murit, punëtorit që sapo kapi kovat nga kanxha e litarit. — Të mbyllim plotësisht këtë vijën e plasur një herë. . .

Avdiut i dogji gishtin cigarja.

— U mbyll edhe kjo e plasur.

— Sa të plasura kemi mbyllur, aq të mira qofshin. Ja, me këtë mistri, me këto duar.

Fatmiri u mbështet te parmaku prej hekuri dhe shikoi poshtë.

— Shpejtoni edhe ca, Safet, ta mbarojmë sa më parë!

— Pa na zënë edhe shiu — foli Avdiu. Ai u çudit me veten që kishte dalë në të kundërtën e dëshirës së mëparshme, që priste shiun nga çasti në çast.

«Përderisa u betonua më tepër se gjysma e ballkonit. . .»

Retë po bëheshin më të ngjeshura dhe ngjyra e tyre sa vinte e nxihej. Çikriku nën forcën tërheqëse të duarve të Safetit rrotullohej me shpejtësi, litari mbështillej e çmbështillej pas çikrikut, kovat ecnin thuajse me të rendur lart e poshtë.

Inxhinieri s'ja ndante sytë grumbullit të betonit atje poshtë, që dukej si mospërfillës.

«Dhe sa kova duhen mbushur që të mbarohet? Ta zëmë pesëdhjetë, nga një minutë, pesëdhjetë minuta».

Filluan pikat e para të shiut.

«Retë e dhanë sinjalin e alarmit».

Mistria në dorën e Fatmirit lëvizte më me shpejtësi mbi sipërfaqen e betonit.

Pikat e shiut, që në fillim ishin të mëdha e të rralla, u kthyen në të vogla e u dëndësuan.

Avdiut i erdhi pak si ligisht që punëtorët, ndërsa shpejtonin të betononin, lageshin, kurse ai rrinte te dera e dhomës që nxirrte në ballkon.

«Dhe janë të djersitur... Po që të dal edhe unë të lagem kot së koti, s'ka kuptim...»

Fatmiri mbushi disa mistri me beton dhe i hoqi mënjanë.

— Shikoni, keni kujdes se po e përzieni me llumin e baltës që krijohet nga uji i shiut — u tërhoqi vërejtjen atyre poshtë.

Avdiu as që e vuri re dhe as që e mori vesh menjëherë, përse Fatmiri e largoi atë beton nga shtresa. Por, kur dëgjoi fjalët e tij, u drodh si të kërcente nga një pickim i papritur. Një mendim i trembur ju fut në tru, si një hardhucë kur futet në vrimën e murit.

U nis me hapa të shpejtë për në drejtim të shkallëve.

Atje poshtë ishin marrë masat në një kohë rekord. Betoni që rrethuar midis tri dërrasave dhe përsipër ju hodhën dy fletë llanarine.

Rrobet e punëtorëve ishin bërë qull.

Inxhinieri, si ndjeu lagësirën e shiut në flokë dhe në gropën e qafës, ngurroi të largohej e të futej përsëri brenda. I vinte zor.

Safeti, ndërsa punëtori lart po merrte kovat, nxori kutinë e duhanit dhe mudohej të mbushte çibukun.

— M'u tek keq — tha. — M'u ça hunda.

Avdiu me të shpejtë mori një cigare nga paqeta e tij dhe ja afroi te buzët.

— Janë të buta — tha Safeti. — Po deshe, mbaje litarin sa të mbush çibukun!

Avdiu e kapi. Punëtori lart se vuri re kush e mbante litarin dhe i vari kovat në kanxhë. Avdiu ndjeu peshën dhe kapi dorezën e çikrikut. E vërtiste ngadalë.

Kovat me buzë të shtrembëruara dhe të zhyera përplaseshin me njëra-tjetrën. Avdiut ju duk se po e përqeshnin, po talleshin që i ulte aq ngadalë. Dhe i lëshoi me shpejtësi.

Safetit s'po i ndizej çakmaku. Ja lagnin pikat e shiut.

— Shko ndize brenda — i tha Avdiu.

Litari i tendosur nga pesha e dy kovave të mbushura me beton, që ngjiteshin lart, mbështillej me shumë zor pas çikrikut. Avdiu shikonte gishtat e tij të ngërthyer pas dorezave sikur do të thyheshin.

«Ta dija se kjo punë donte kaq shumë forcë... Por meqë fillova...»

Safeti vazhdonte ta thithte çibukun qetë-qetë.

Avdiu shtrëngohej pas çikrikut. Dhëmbët i kërçisnin nga sforcimi. Sytë i hidhte herë pas here nga grumbulli i betonit. Dëshironte që të mbarohej në çast.

Safeti shkundi çibukun dhe kapi çikrikun.

PAS SHIUT, SHKËLQEJNË YJET

Kështu e kanë shirat e beharit, fillojnë menjëherë dhe pushojnë papritur. Mund të ndodhë që të dalësh nga shtëpia me diell, dhe pas pak të kërçasë

shiu litar. Atëhere ti kthehesh në shtëpi e merr çadrën dhe, kur del përsëri jashtë, retë janë shpërndarë.

Në këto mendime ishte Avdiu, ndërsa ruhej të mos shkelte në pellgjet me ujë. Retë vraponin nëpër hapësirë si sorra të trembura. Gjethet e pemëve anës rrugës pikonin. Asfalti shkëlqente. Ai vetë qe lagur i tëri dhe me hapa të mëdhenj ecte për në shtëpi. Atje do të fshihej, të ndërrohej dhe do të çlodhej.

«Si dreqin ndodhi kështu? Kujtoja se do ta kaloja pa u lagur!»

Nga pas e ndiqte zhurma e çikrikut, drëng, drëng, drëng. Gishtat e tij, duke u ngjeshur pas dorezave të drunjta, të lagura të çikrikut qenë shtypur pak.

Ballkoni kishte mbaruar së betonuari për së dyti herë dhe Avdiu ndjente brengosje e lehtësim në të njëjtën kohë. Kjo punë u krye kundër dëshirës së tij, por në fund të fundit i vuri kapak shqetësimit të atyre ditëve. Sipër të plasurës së parë ngjishej shtresa e dytë e betonit, e fortë, e palëvizshme. «U mbyll edhe kjo e plasur».

Avdiu ndjente dobësi. Kishte dalë kundër mendimeve që i mbronte me forcë, kundër të gjithëve. Ai donte që ajo e plasur të mos mbyllej, por të shërbente si mjet, si provë për ta detyruar Fatmirin të ulte kokën. Dhe në fakt...

Tundi dorën e djathtë me nervozizëm, e futi në xhep dhe nxori paqetën. Por ajo ishte lagur plotësisht. E mblodhi shuk dhe e hodhi mbi asfalt.

«Fatmiri e ka lënë duhanin. Safeti e pi vetëm me çibuk...»

Rrobet e lagura i ngjiteshin pas trupit. Retë shpërndaheshin. Njerëzit vërshonin të zhurmshëm

nëpër rrugë. Avdiu i hidhte hapat të gjatë.

Sapo vuri gishtin te zilja e derës, ndjeu pantoflat e së shoqes në korridor. «S'duket të jetë me inat, megjithëse edhe sot jam vonuar. Po kur të më shohë kështu të lagur!?»

Ballkizja mezi e njohu, kur e pa ashtu me flokët shkatërruar, të varur sipër ballit. Ajo e vërejti me çudi.

— Oh, qenke qullur — tha dhe vrapoi t'i bënte gati teshat për t'u ndërruar. — Hiqi, hiqi shpejt, se do të ftohesh. Po si nuk u fute diku derisa të pushonte shiu?

— Ashtu kishim një punë dhe e mbaruam.

— Punë në shi?! Çfarë pune qenka kjo?!

— Beton hesapi.

— Fshihu dhe ndërrohu shpejt!

Ishte hera e parë që donte ta ndihmonte më shumë, mbase ngaqë kësaj here ai i dukej më i pafuqishëm. Qysh ditën e parë pas plasjes së ballkonit, (kur ai erdhi vonë dhe ajo e priti keq) Ballkizja e vinte re se s'qëndronte dot më e shkujdesur ndaj të shoqit. E plasura e ballkonit, e reflektuar hapur në ndërgjegjen e Avdiut, bëri që Ballkizja të shihte qartë të plasurën në marrëdhënjet bashkëshortore. Grindjet, keqkuptimet, mosmarrëveshjet e deriatëhershme në familje i quante si diçka të pashmangshme, njëlloj karakteristike të vetë egzistencës së familjes. Dhe kur e konstatoi se kjo që një e plasur e dëmshme që, po të mos luftohej për ta mbyllur, do të zgjerohej më shumë, u trondit, u trondit pa masë. Dhe zuri t'i mbetej mendja te vetullat e tija të vrejtura, te lëvizjet nervoze të duarve, tek ecja me hapa të rëndë mbi dysheme, te sytë e rënduar

e të lodhur nga pagjumësia. Gjella e mbetur mbi tryezë gjysëm e ngrënë pohonte shumë. Ballkizja po futej e gjitha në shqetësimin e Avdiut.

Ajo po mendohej të hynte e tëra në shqetësimin e tij, në mendimet e tij. Formalizmi i jetës së tyre po humbiste, po shembej.

Si veshi rrobat e thata, Avdiu e ndjeu veten të lehtësuar, si të liruar nga një peshë e rëndë, shtypëse.

— Paskam uri.

Ajo vuri tenxheren e gjellës në furnellë që të ngrohej dhe e lehtë e shkathët doli jashtë.

Pas pak u kthve me një shishe vere «Sheshi i zi». E dinte që Avdiu e pëlqente shumë atë lloj vere.

— Sonte kemi festë, Adi. Do të të them diçka të gëzueshme.

Ai s'po kuptonte dhe vërente me habi fytyrën e çelur të së shoqes.

«Po kjo ç'qenka përtëritur e zbukuruar kështu sonte?»

— Do të kemi një fëmijë!

— Si?!

— Po, — tha ajo duke u dridhur.

Avdiut s'i bëhej të besonte.

— Me gjithë mend, Kizi?!

— Me gjithë mend e që ç'ke me të. Dhe u ul pranë. — Po bëj një javë e më tepër që e mora vesh, por s'më mbushej mendja, s'e besoja... Veç kësaj edhe ti ke qenë pothuajse i dërmuar gjithë këto ditë... Kurse sonte më dukesh krejt ndryshe.

— Kizi, prit, se do ta shtroj unë tryezën.

Ajo qeshi.

Ai filloi të përfytyronte fëmijën e vogël duke luajtur nëpër shtëpi.

«Kujt do t'i ngjajë? Po të jetë djalë, të më ngjajë. . . Jo, më i mirë se unë duhet të bëhet. Në qoftë vajzë, të bëhet. . . po, si Kizi sonte. . .»

Shtëpia i dukej më e madhe nga zakonisht dhe sikur sa vinte e zgjerohej më shumë. Natyrisht, duhej të mjaftonte për tre vetë. Atë natë në atë shtëpi, frynte një fllad i ri. Ishte një lumturi familjare që ata e kërkonin prej kohësh.

O O O

Herët në mëngjez, 29 ditë pas betonimit të dytë u bë prova e ballkonit. Të gjithë e dinin mirë që kjo punë kryhej vetëm sa për të përmbushur një rregull të caktuar, mbasi duhej shënuar në proces-verbalin e dorëzimit të ndërtesës. Një formalitet që duhej.

Si u vu pesha dhe hoqën mbështetëset, Avdiu e mati përkuljen e ballkonit, buzëqeshi dhe u tha të pranishmëve:

— S'ka vend për dyshim këtu. Kam qenë vetë gjatë gjithë kohës kur u krye betonimi.

Në fjalët e tij ndjehej ai toni krenar e egoist. Avdiu e kapi këtë ndjenjë në fytyrat e atyre që u drejtohej dhe tha me një ton tjetër:

— Kësaj radhe po, kemi bërë punë të saktë.

Zijai e pa dhe e kuptoi.

«Po ndryshon, më në fund po fillon të ndryshojë» — tha me vete Zijai.

Fatmiri murmuriti një «mirë, mirë» dhe s'e cyti më tej. «Do të bindesh për të gjitha, more shok, do të bindesh.»

Të dy, Zijai e Fatmiri, s'dëshironin t'i frynin.

zjarrit atë mëngjez, zjarr që mund të merrte flakë menjëherë.

Të gjithë heshtnin dhe në heshtjen e tyre kishte qortim e dëshirë që ai të ishte me ta, të ishte pranë tyre, të gjithëve.

O O O

Avdiu sapo e veshi kostumin blu dhe vuri gravatën ngjyrë bari. I shkoi duart pas mjekrës së saporruar. E shoqja po lyente fytyrën me krem «Nivea» dhe ashtu siç i kishte duart, ja fërkoj pas faqeve të shoqit.

— Eee, jam bërë i mirë? — tha ai si me llas-tim.

Trokiti dera.

Ballkizja e hapi. Ç'kërkonte ai burrë me mustaqe kapardisur. Dhe gjithë ata të tjerë pas?! Njërin prej tyre e njihte, inxhinier Zijain. «U, qenka dhe ai djali, brigadier Fatmiri».

— Mirë se ju gjejmë — tha Safeti dhe i zgjati dorën.

— Mirë se erdhët!

Ata hynë njëri pas tjetrit. Avdiu u jepte dorën dhe detyrohej të vinte buzën në gaz. Dëgjoi që e uronin «Njëqind vjeç!» «Me mjekër të bardhë!» Si t'ua kthente këto urime?

Mysafirët u ulën në dhomën e pritjes. Të zotët e shtëpisë rrinin më këmbë.

— Sikur ju shoh që mendoni — tha Zijai. — Mos keni ndonjë gjë?..

Të zotët e shtëpisë mblodhën supet. Me ç'rast po u vinin ata njerëz?